
**PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR
NËNPUNËS CIVILË DHE NGRITJA
E KAPACITETEVE TË TYRE PËR
TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE
KUNDËR DISKRIMINIMIT NË KOSOVË**

Tetor, 2018



Mirënjohje

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

ECMI Kosova (www.ecmikosovo.org)

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

**Rr. Nëna Terezë Nr. 20, Apt. 5,
10000 Prishtinë – Kosovë,
Tel. +381 (0) 38 224 473**

**Rr. Kralja Petra 183 a
38220 Mitrovicë e Veriut – Kosovë**

Equal Rights for All Coalition

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC) bashkon shtatë (7) OJQ-të që punojnë në fushën e **sundimit të ligjit** dhe **të drejtave themelore** në bashkëpunim të ngushtë me **nëntëmbëdhjetë (19) OJQ të angazhuara kryesisht në nivel lokal**, me një fokus të veçantë në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara (GRM-ve). Fokus specifik i projektit janë grupet si në vijim: **të gjitha komunitetet jo-shumicë** në Kosovë, **gratë, rinia**, dhe **pjesëtarët e komunitetit LGBT**. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarët e ERAC janë organizatat e mëposhtme:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë - Lidere e Koalicionit të drejtat e barabarta për të gjithë;
- Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore;
- Qendra për Barazi dhe Liri të pjesëtarëve të komunitetit LGBT në Kosovë;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut;
- Glocal Kosova;
- Centre Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional.

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

E drejta autoriale

© Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), korrik 2018. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR NËNPUNËS CIVILË DHE NGRITJA E KAPACITETEVE TË TYRE PËR TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE KUNDËR DISKRIMINIMIT NË KOSOVË



European
Union
Kosovo

I.	Përmbledhje.....	9
II.	Hyrje.....	10
III.	Metodologjia.....	12
IV.	Mekanizmat për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të Komuniteteve.....	13
	Niveli Qendror i Kosovës.....	13
	Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP).....	13
	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit..	14
	Zyra për Çështje të Komuniteteve.....	15
	Këshilli Konsulativ për Komunitete.....	15
	Zyra e Komisionerit për Gjuhët.....	17
	Ministria për Komunitete dhe Kthim.....	18
	Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthyerit.....	18
	Administrata Publike në nivel Qendrorë.....	19
	Niveli Lokal i Kosovës.....	21
	Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).....	21
	Njësitë Komunale për të drejtat e njeriut.....	22
	Komiteti Komunal për Komunitete.....	22
	Institucionet e Pavaruara.....	21
	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës.....	22
	Administrata Publike në Nivel Lokal.....	23
V.	Zbatimi i Ligjit.....	29
	Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).....	29
	Gjyqësori.....	29
	Vlerësimi i Cilësisë së Trajnimeve ofruar Gjyqësorit.....	31
	Forca Policore e Kosovës.....	32
	Vlerësimi i trajnimeve të ofruara Akademisë së Policisë	34
VI.	Përfundimet.....	38
VII.	Rekomandimet.....	39
VIII.	Referencat.....	41
IX.	Shtojca 1.....	44

LISTA E SHKURTESAVE

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAP	Ministria e Administratës Publike
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MI	Ministria e Infrastrukturës
MHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MBZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AZHB	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
AZHB	Agjencia për Zhvillimin Bujqësisë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
OIK	Institucioni i Avokatit të Popullit
IPK	Inspektorati i Policisë së Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
KDIKK	Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthyerit
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ShShPK	Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
KMDLNj	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
IPV	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë

ERAC	Koalicioni Të drejtat e barabarta për të gjithë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ZIDDNj	Zyrapër Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
DTPA	Departamentit të Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore

I. PËRMBLEDHJE

Ky raport përshkruan masat legislative dhe institucionale të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për të adresuar çështjet e diskriminimit etnik në shërbimin publik të Kosovës dhe për të ofruar trajnime mbi barazinë ndër-etnike. Sipas raportit "Mbrojtja ligjore kundër diskriminimit në Evropën Juglindore", publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) në vitin 2016, identifikimi, raportimi, trajtimi madje edhe evidentimi i diskriminimit në Kosovë mbetet në nivel të pakënaqshmëm.¹ I lidhur pjesërisht me traditën dhe kulturën në lidhje me të drejtat e njeriut, dhe mosregjistrimin e rasteve të diskriminimit, ky raport do të adresojë mungesën e organizimit të trajnimeve për nënpunësit civilë, trajnime këto që trajtojnë temën të drejtat e njeriut dhe diskriminimit, si dhe do të shpjegojë se si diskriminimi është tejet i theksuar në nivelin institucional. Ky raport është i rëndësishëm sidomos duke e pasur parasysh planin e vazhdueshëm strategjik të Qeverisë së Kosovës për trajnimin e nëpunësve civilë (2016-2020), i cili synon të arrijë gradualisht standardet e BE-së, mirëpo, ende dështon në trajnimin e nëpunësve civil për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve në veçanti.²

Për qëllim të publikimit të këtij raporti, një numër i zgjedhur i përfaqësuesëve të institucioneve publike dhe institucioneve relevante u kontaktuan, ku u bë analizimin i qëllimeve të tyre si institucione, masat e ndërmarra për të arritur këto qëllime, zbatimi i tyre dhe cilësia e rezultateve të trajnimit. Përzgjedhja është bërë për të pasqyruar trajnimin në institucione, anëtarët e të cilëve janë në kontakt më të shpeshtë me publikun dhe/ose janë urë lidhëse e komunikimit ndërmjet qeverisë lokale dhe qendore. Të gjeturat e këtij raporti pasqyrojnë një rënie të interesit në arsimin metodik dhe të gjërë, duke i marrë parasysh sfidat që kombinohen në mes të indiferencës legislative dhe mbështetjes institucionale të cilat kanë bërë që ky proces të ketë ngecje. Për më tepër, dokumentacioni i kufizuar i përmbajtjes së trajnimeve të cila u janë ofruara nëpunësve civil deri më tani ka bërë që vlerësimi të jetë sfidues në aspektin e rezultateve afatgjata.

¹ Qendra për SEELS, 2016. Mbrojtja Ligjore nga Diskriminimi në Evropën Juglindore: Studim Rajonal, fq. 267

² Shiko shembullin: Ministria e Administratës Publike, Strategjia për Trajnimin e nëpunësve Civil 2016-2020; Qeveria e Kosovës, Plani I Veprimit për periudhën tre vjeçare 2016-2018 për implementimin e Strategjisë për Trajnimin e nëpunësve Civil 2016-2020.

Në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventa mbi Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit racor, janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Qeveria e Kosovës ka miratuar legjislacionin për mbrojtje kundër diskriminimit dhe ka ndërmarrë një sërë masash institucionale për të rritur dhe promovuar vetëdijen, arsimin dhe trajnimin për nënpunësit civilë në çështjet e të drejtave të pakicave etnike, apo komuniteteve në Kosovë.³ Gjithashtu, i cekur drejtpërdrejtë në Kushtetutë, është edhe Këshilli Konsultativ për Komunitete, organ ky i krijuar për të ndihmuar komunikimin dhe konsultimin mes qeverisë dhe komuniteteve në lidhje me legjislacion dhe politikat e vendit.⁴ Qëllimi dhe funksioni i këtij institucioni do të shpjegohet më vonë në këtë raport.

Veprimi ligjor i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e komuniteteve është marrë në vitin 2008, kur Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 03 / L-047 "Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë", ligj i hartuar për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë, duke u njohur të drejtën e tyre, ndër të tjera, për përdorim të gjuhës së tyre, të drejtën për arsimim, trashëgimi kulturore, identitet dhe religjion.⁵

Ligji i fundit, sipas standardeve ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës, është Ligji Nr. 05 / L-021 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i miratuar më 28 maj 2015.⁶ Qëllimi i këtij Ligji është të mbrojë qytetarët pa dallim kombësie/komuniteti/race, gjinije, seksi, feje, nga diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, ngacmimi dhe viktimizimi në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë mundësinë për punësim, trajnim dhe kushte tjera të punës.⁷ Më e rëndësishmja, në Kosovë të gjitha ministritë dhe komunat janë të detyruar me ligj që të themelojnë njësite për të drejtat e njeriut ose të caktojnë zyrtarë të cilët kanë përgjegjësi të raportojnë dhe të koordinojnë zbatimin e ligjin kundër diskriminimit.⁸

Sidoqoftë, siç do të bëhet e qartë në këtë raport, shumica e këtyre masave ligjore dhe të institucionalizuara janë neglizhuar nga Qeveria dhe organizatat qeveritare të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin dhe implementimin e tyre.

Më e rëndësishmja edhe që edhe pse masat legjislative për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve janë miratuar, sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën në vitin 2016, performanca e institucioneve në adresimin e çështjeve të diskriminimit është e ulët.⁹ Të gjitha ngecjet në zbatim të legjislacionit dëmtojnë frymën e ligjeve të miratuara në Kosovë dhe bëjnë që vetëdijesimi i nënpunësve civil dhe trajnimet për çështjet e komuniteteve të jenë të mangëta.

Numri i popullsisë si dhe komunitetet etnike që jetojnë në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë i cili është bërë në vitin 2011 dhe Profileve Komunale të publikuara nga OSBE-së në vitin 2013, është raportuar të jenë:

³ Kushtetuta e Kosovës, Artikulli 22 'Instrumentet dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare Direkt të Aplikueshme', p. 6

⁴ ibid, Artikulli 60.3.1, 60.3.2 'Këshilli Konsultativ për Komunitete', p. 18

⁵ Kuvendi I Kosovës, 13 mars 2008, Ligji 03/L-047, 'Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë'.

⁶ Kuvendi I Kosovës, 28 maj 2015, Ligji 05/L-021, 'Ligji për mbrojtje nga diskriminimi'.

⁷ Qendra për SEELS, 2016. Mbrojtja Ligjore nga Diskriminimi në Evropën Juglindore: Studim Rajonal, fq. 25

⁸ ibid. 39

⁹ Komisioni Evropian. 2016. Dokument I Punës së Stafit të Komisionit: Raporti I Kosovës 2016 fq. 26

- Rreth 1.8 million qytetarë;
- 87% Shqiptarë të Kosovës;
- 8% Serb;
- 5% të tjerë (Boshnjak 1.54%, Turk 1.01%, Roma 0.84%, Ashkali 0.83%, Egjiptian 0.61%, Goran 0.58%, Kroat për afërsisht 0.01%, Malazez për afërsisht 0.01%)¹⁰.

Veçanërisht për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, ka shprehur shqetësime në raportet vjetore të vitit 2015 dhe 2016. Sipas këtyre dy (2) raporteve, këto komunitete ballafaqohen me diskriminim indirekt, duke u kombinuar me varfërinë e skajshme, në qasjen në asistencën sociale dhe në rastet kur kthehen në Kosovë.¹¹ Veçanërisht në raportin vjetor të vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, ka shprehur shqetësime serioze për problemet e përgjithshme me të cilat këto tre (3) komunitete ballafaqohen, dhe, më e rëndësishmja, është që kjo situatë nuk shihet të ketë ndonjë përmirësim në të ardhmen.¹² Edhe raporti i vitit 2017, vë një thekst të veçantë tek problemet që hasin këto tri (3) komunitete dhe se sa të ndijshëm dhe të marginalizuar janë në Kosovë.¹³

Siç do të shihet në këtë raport, mungesat në nivele strukturore të ndërlidhura nga një mos vetëdije e nënpunësve civil për të drejtat e komuniteteve si dhe mungesa e programeve të trajnimit, janë çështjet të cilat cilësohen si dobësi institucionale në adresimin e diskriminimit indirekt karrshi komuniteteve në Kosovë.

Në kapitujt e mëposhtëm, ky raport do të adresojë funksionimin e institucioneve dhe organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare, praktikën e tyre të ndërlidhur, si dhe planifikimin strategjik qeveritar për të ardhmen dhe të nxjerrë përfundime rreth ngecjeve institucionale që deri tani kanë penguar trajnimin e nënpunësve civil për mbrojtjen dhe promovimin e çështjeve të komuniteteve.

¹⁰ ECMI Kosova. 2013. Komunitetet në Kosovë: Udhërrëfyes për profesional që punojnë me komunitete në Kosovë, [Verzioni Anglisht] fq. 12-61

¹¹ Institucioni i Avokatit të Popullit. Raporti Vjetor 2015: Nr. 15, fq. 51

¹² Institucioni i Avokatit të Popullit. Raporti Vjetor 2016: Nr. 16, fq. 67

¹³ Institucioni i Avokatit të Popullit. Raporti Vjetor 2017: Nr. 17, fq. 78-80

III. METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në mungesat e evidentimit dhe adresimit të diskriminimit në nivel institucional, fakt ky që bërë që struktura e këtij raporti e mbledhjes së të dhënave të bëhet përmes burimit primar (intervistat dhe pyetësorët me institucionet publike) si dhe materialit dytësor (pamflete, raporte vjetore institucionale, legjislacion etj.). Në këtë mënyrë, boshllëqet në informacionin ekzistues mbulohen nga njohuritë e thelluara të mbledhura nga zyrtarët kompetentë të institucioneve të përfshiera në përpilim të këtij raporti. Në këtë mënyrë, boshllëqet në informacionin ekzistues mbulohen nga njohuritë dhe informacionet e mbledhura nga zyrtarët nga institucionet e kontaktuar.

Pyetësorë janë shpërndarë tek të gjitha Komunat dhe Ministrinë, me qëllim që të vlerësojmë qëllimin dhe ndikimin e trajnimeve që organizohet për të drejtat e njeriut. Në të njëjtën kohë, intervistat specifike me institucionet e ndryshme ofruan informacione rreth aspektit administrativ të trajnimit, si dhe sfidat dhe planet e ardhshme. Për më tepër, ECMI Kosova siguroi qasje në kurrikulat e Akademisë së Drejtësisë dhe Akademisë së Policisë për analizën e përmbajtjes dhe identifikoi hapësirë për përmirësim të mundshëm.

Për institucionet që nuk organizojnë trajnime për nënpunësit civil në kuadër të tyre, por mbështeten nga institucionet tjera (si Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Këshilli Konsultativ për Komunitete, ndër të tjera), intervistat janë fokusuar të vlerësojnë profesionalizimin institucional në organizimin e trajnimve për të drejtat e njeriut, pikëpamjet e tyre në lidhje me progresin apo regresin, si dhe planet e ardhshme.

Përodrimi i kësaj metode dhe qasjeje, i ka shfaqur dy (2) sfida me të cilat është përballur ECMI Kosova gjatë hulumtimeve të material ekzistues. Nga njëra anë, të dhëna të diskriminimit me të cilin përballen komunitetet në Kosovë janë të regjistruara minimalisht, siç e theksuar nga shumë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, ku shumica e rasteve nuk raportohen dhe nuk shkojnë në nivel gjyqësor. Si të tilla, këto raste nuk janë integruar asnjëherë dhe nuk gjinden si statistikë. Nga ana tjetër, ky problem i mos-mbledhjes së statistikave apo rasteve të diskriminimit, është rritur kur organizimin e trajnimve të nënpunësve civil, për shembull rasti i gjyqësorit ku deri në vitin 2018 stafi administrative është trajnuar nga IKAP kurse Gjyqtarët dhe prokurorët janë trajnuar nga Akademia e Drejtësisë, duke krijuar kështu një mospërputje në fushën dhe përmbajtjen e trajnimeve të organizuara. Për të mbuluar këtë boshllëk në statistika dhe bashkëpunim ndër-institucional, pyetësorët janë përdorur të sjellin të dhëna nga përvojat e pjesëmarrësve kurse zyrtarët më të lartë janë intervistuar në lidhje me çështjet e identifikuara nga tëgjeturat e ECMI Kosovë gjatë hulumtimeve të bëra si dhe përgjigjet e pjesëmarrësve.

Si i tillë, raporti është i strukturuar dhe ndarë në dy pjesë, duke u përgjigjur këtyre dy kategorive të ndryshme të institucioneve dhe burimeve të informacionit. Pjesa e parë analizon institucionet që menaxhojnë trajnimin e drejtpërdrejtë të nënpunësve të ardhshëm civil dhe përgjigjet e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, kurse pjesa e dytë i kushtohet mekanizmave të zbatimit të ligjit. Në këtë mënyrë, praktika dhe politika vlerësohen dhe krahasohen, me qëllim të nxjerrim përfundime rreth gjendjes së ardhshme të trajnimit kundër diskriminimit, të drejtave të komuniteteve dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi. Raporti përfundon me disa rekomandimet dhe veprimet e ardhshme të ECMI Kosovës dhe ERAC.

IV. MEKANIZMAT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE

Niveli Qendror i Kosovës

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është themeluar si agjenci nën Ministrinë e Administratës Publike. Roli kryesor i IKAP-it është të organizojë trajnime për nëpunësit civilë në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e shërbimeve civile në administratën publike dhe institucionet e Kosovës. Çdo vitë, IKAP-i publikon raportet vjetore për trajnimet e nëpunësve civilë.¹⁴

Në vitin 2015, IKAP-i ka trajnuar gjithsejt 2,768 nëpunës civilë përmes 88 moduleve trajnuese në 303 seanca të organizuara të trajnimit. Pjesëmarrësit në këto trajnime ishin nga nivelet e larta të menaxhmentit, të nivelit profesional dhe administrativë me një përfaqësim më të gjerë duke përfshirë të gjitha Ministrinë, Ekzekutivin, Agjensitë e Pavarura dhe Komunat. Struktura gjinore e pjesëmarrësve në këto trajnime përbëhet nga 39.70% femra dhe 60.30 meshkuj, nga ta, 3.07% ishin përfaqësues nga komunitetet që flasin gjuhën serbe. Nga institucionet e nivelit qendror, në trajnimet e organizuara nga IKAP-it gjatë tërë vitit morën pjesë gjithsejt 1,392 persona kurse nga institucionet e nivelit lokal morrën pjesë gjithsejt 1,376 persona. Kështu që, 50.29% e pjesëmarrësve në trajnimet e organizuara ishin përfaqësues të institucioneve të nivelit qendrorë dhe 49.71% të institucioneve të nivelit lokal.¹⁵

Gjatë vitit 2016, IKAP-i ka trajnuar gjithsejt 3,761 nëpunës civilë përmes 135 moduleve të trajnimit në 619 seanca të organizuara të trajnimit. Pjesë e këtyre trajnimeve ishin gjithashtu edhe 100 pjesëmarrës nga kompanitë e prokurimit publik. Trajnimi u ndoq nga zyrtarë të lartë profesionalë dhe administrative, duke përfshirë Ministrinë, Ekzekutivin, Agjensitë e Pavarura, Komunat, Ndërmarrjet Publike, Gjyqtarët dhe Njësitë Rajonale. Struktura gjinore e pjesëmarrësve në këto trajnime përbëhet nga 40.63% femra dhe 59.37% meshkuj, ku 14.09% prej pjesëmarrësve ishin përfaqësues të komuniteteve që flasin gjuhën serbe. Nga institucionet e nivelit qendror, në trajnimet e organizuara nga IKAP-it gjatë tërë vitit morën pjesë gjithsejt 2,824 persona kurse nga institucionet e nivelit lokal morrën pjesë gjithsejt 937 persona. Kështu që, 75.08% e pjesëmarrësve në trajnimet e organizuara ishin përfaqësues të institucioneve të nivelit qendrorë dhe 24.91% të institucioneve të nivelit lokal.¹⁶ Pjesë e moduleve të këtyre trajnimeve ishin të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve, mirëpo asnjë modul nuk mbulonte vetëm fushën e të drejtave të njeriut në formë më të detajuar.

Gjatë vitit 2015, një trajnim dy (2) ditor mbi të drejtat, përgjegjësitë dhe ankesat në shërbimin civil është organizuar. Trajnimi ishte i dedikuar për punonjësit e komunave të Kosovës, ku gjithsejt ishin 40 pjesëmarrës, duke përfshirë dy (2) trajnerë.

Për më tepër, për modulin e të drejtave të nëpunësve civil, u organizua një (1) trajnim i cili kishte për qëllim të mbështes procesin e integritetit të komunitetit Serb në institucionet shtetërore në Veri të Kosovës. Në këtë program trajnimi janë trajnuar gjithsejt 318 nëpunës civilë të ndarë në njëmbëdhjetë (11) grupe trajnuese, duke përfshirë gjashtë (6) trajnerë. Pjesëmarrësit e këtij trajnimi ishin nga katër (4) komunat veriore: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin-Potok dhe Leposaviq.

¹⁴ Intervista me Refiçe Sylqevci, Drejtoreshë e IKAP

¹⁵ IKAP Raporti Vjetor 2015

¹⁶ IKAP Raporti Vjetor 2016

Institucionet të cilat ishin përfituese të programit janë: MAPL, MASHT, MPMS, MAP, ASHI, MAPH, MKRS, MZHE, MBZHR, MTI, MKK, AKK, AZHB, ATK, ASK-ZSK, AUV and KRU.¹⁷

Në vitin 2017, IKAP filloi të punojë në modulin "Të Drejta të Njeriut në Kosovë" dhe manualin e këtij moduli, të cilat janë në fazën përfundimtare. Aktiviteti i radhës do të jetë organizimi i trajnimit për trajnerë të cilët do të certifikohen nga ZQM dhe projekti i financuar nga Komisioni Evropian. Këta trajnerë janë të paraparë të përfshihen në organizimin e modulit "Të Drejtave të Njeriut në Kosovë".¹⁸

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit (Zyra për Qeverisje të Mirë/ZQM) u krijua në vitin 2001 dhe operon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe mbikqyrë përpjekjet e Qeverisë në lidhje me të drejtat e njeriut (duke i u dhënë këshilla Ministrave dhe Kryeministrit në lidhje me të drejtat e njeriut, përpilimin dhe rishikimin e politikave, komunikimin me publikun e kështu me radhë).¹⁹ Në ZQM janë të angazhuar tetë (8) shërbyes civil, dhe përbëhen nga Drejtor; Koordinator; zyrtar i lartë për të drejta të fëmijëve; zyrtar i lartë për qeverisje të mirë; zyrtar i lartë për mundësi të barabarta dhe aftësi të kufizuara; zyrtar i lartë për mundësi të barabarta dhe komunitete; zyrtar i lartë kundër diskriminimit; dhe asistent administrativ.²⁰

Sipas drejtorit të zyrës, Z. Habit Hajredini, përgjegjësia kryesore e zyrës është organizimi i trajnimeve që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civil që janë pjesë e zyrës.²¹ Trajnimet janë në lidhje me temën e të drejtave të njeriut, me focus të veçantë për shembull, komunitetet dhe diskriminimit, dhe përmbajnë tema të specializuara si personat me aftësitë kufizuara nga komunitetet. Në përgjithësi, Z. Hajredini përmendi trajnimet për komunitetet të cilat fokusohen më shumë tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe gjithashtu theksoi që ZQM organizon një sërë seminaresh dhe punëtorish në nivel lokal dhe qendrorë në fushën e shëndetësisë, banimit, dhe mirëqenies sociale, ku pjesëmarrës janë nënpunësit civil. ZQM ka zhvilluar program të trajnimit në kuadër të zyrës, në fushën e të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta, të cilat janë pjesë e një projekti gjatë (6) mujorë, i cili pastaj është prezantuar te IKAP për të u zbatuar. Përgjatë vitit të kaluar, ky program është zbatuar në kohë prej pesë (5) ditëve, ku pjesëmarrës ishin nëntëmbëdhjetë (19) nënpunës civil të cilët janë certifikuar dhe mund të shërbejnë si trajnerë të fushave të lartpërmendura. Program i njëjtë i trajnimit është përpiluar dhe është përfunduar me mbështetje të ZQM-së.

Veprim i rëndësishëm duket të ketë qenë institucionalizimi i një mekanizmi që do të mirret me ngritjen e kapaciteteve të nënpunësve civil në çdo Ministri. Sipas iniciatives së re të ZQM-së, secila Komunë do të ketë një anëtar të stafit që punon në mënyrë specifike në fushën kundër-diskriminimit. Në vitin 2017, duke e marrë parasysh këtë vendim, ZQM-ja ka filluar me procesin e trajnimit të nënpunësve civilë për të kuptuar më mirë këtë strukturë administrative të re. Nënpunësi civil i përzgjedhur, ka përgjegjësi të shpërndajë të gjitha njohuritë dhe informatat e nevojshme tek nënpunësit e tjerë civilë në komunën përkatëse, ku përfshihen edhe informatat në lidhje me rastet e diskriminimit dhe komunitetet.

¹⁷ Përgjigjja e IPAK për pyetjen e bërë në lidhje me çasjen në dokumenta publike, janar 2018.

¹⁸ Intervista me Refiçe Sylqevci, Drejtoreshë e IKAP, janar 2018.

¹⁹ Kosovë. Rregullorja Nr.16/2013 ne strukturën organizative të Zyrës së Kryeministrit [05.04.2013], Artikulli 40 "Zyra për Qeverisje të Mirë", fq. 64-67

²⁰ ibid. p. 68

²¹ Intervistë nga përfaqësuesit e ECMI dhe ERAC e bërë të mërkurën 04 prill 2018, tek zyret e Z. Hajradini.

Zyra për Çështje të Komuniteteve

Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) është trup këshilldhënës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe ka mandat të raportojë për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet tek Kryeministri i Kosovës. ZÇK u themelua në vitin 2008, ku si përgjegjësi ka koordinimin e politikave dhe konsultimin me komunitetet, mirëpo si zyrë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, gjithashtu mund të këshillojnë dhe kontribojë në politikat qeveritare për çështjet e komuniteteve, monitorojnë zbatimin e veprimeve të Qeverisë si dhe të ligjeve dhe politikave që prekin komunitetet.²² Zyra përbëhet nga gjashtë (6) nënpunës civilë, ku dy (2) janë zyrtarë të lartë të politikave; një (1) zyrtarë i lartë për komunikim me publikun; dy (2) zyrtarë të lartë për koordinim dhe dhënie të granteve; dhe një (1) zyrtarë administrativ.²³

Siç shihet në Buletinin vjetor të tyre dhe artikuj në gazeta, ZÇK po drejton një portofol të gjerë të aktiviteteve të ndryshme që shtrihen nga iniciativat për strehim dhe programet kulturore deri tek organizimi i konferencave dhe trajnimeve të ndryshme.²⁴ Sipas të dhënave të publikuara online, nuk ka informacion për organizimin e ndonjë trajnimi specifik për ngritjen e vetëdijes së çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet apo të drejtat e njeriut që është organizuar apo organizohet për stafin e ZÇK-së.

Këshilli Konsultativ për Komunitete

Kushtetuta e Kosovës, neni 60, përcakton themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete (Këshilli). Sipas Kushtetutës, mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin: ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës; mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria; për të sygjerruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse; dhe çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin.²⁵ Këshilli përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe një numër përfaqësuesish nga Qeveria e Kosovës, të cilët punojnë dhe janë të specializuar në çështjet e komuniteteve. Edhe pse është trup i themeluar me qëllim për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, është e rëndësishme të theksohet se nuk ka fuqi veto mbi legjislacionin apo ndonjë rregullore.²⁶ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) raportoi që deri në vitin 2012, një numër i madhë problemesh kanë ndikuar në mosfunksionimin e Këshillit. Në nivelin administrative, Qeveria nuk ka publikuar ndonjë strategji apo raport në Kuvend në lidhje me këtë çështje.²⁷ Disa masa edukative u zbatuan dhe disa çështje që kishin të bëjnë me diskriminimin u përfshinë në legjislacionin për punë, sipas të gjeturave të OSBE-së, mirëpo, asnjë program specifik apo initiative nuk ishte marrë për të adresuar diskriminimin në punë që u bëhet komuniteteve.²⁸ Njëjtë, asnjë masë specifike nuk është zbatuar për anëtarët e komuniteteve në fushën e shëndetësisë, dhe progres ivogël është shënuar në zbatimin e Ligjit për Komunitete, sipas të gjetura të OSBE-së.²⁹

²² Visoka, G., Beha, A. Trupat Konsultuese të komuniteteve në Kosovë: Kërkimi për Emancipim Efektiv ose Pjesëmarrje abstrakte? Gazeta mbi etnologjinë dhe çështjet e komuniteteve pakicë në Evropë, vëll. 10, Nr.1 (2011), fq. 16

²³ N.N. [Zyra e Kryeministrit/Zyra për Çështje të Komuniteteve], <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,134> [Accessed: 21 mars 2018]

²⁴ Shikoni shembujt në artikujt informative të publikuar gjatë viteve 2010 dhe 2013, në këtë link: <http://www.zck-ks.net/?page=2,120> [Accessed: 22 mars 2018]

²⁵ Kushtetuta e Kosovës, artikulli 60.3.1, 60.3.2 'Këshilli Konsultativ për Komunitete', fq. 18

²⁶ Visoka, G., Beha, A. Trupat Konsultuese të komuniteteve në Kosovë: Kërkimi për Emancipim Efektiv ose Pjesëmarrje abstrakte? Gazeta mbi etnologjinë dhe çështjet e komuniteteve pakicë në Evropë, vëll. 10, Nr.1 (2011), fq. 15

²⁷ Minisioni I OSBE në Kosovë. 2012. Implementimi I masave për legjislacionin I cili ka ndikim në të drejtat e njeriut, fq. 17

²⁸ ibid. fq. 18

²⁹ ibid. fq. 18-19

Në vitin tjetër (2013), problemet strukturore të Këshillit u bënë më evidente. Pas intervenimit të Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë (ECMI Kosova), cila organizoi një punëtori dy (2) ditore me anëtarët e Këshillit, problemet kryesore të cilat kishin kontribuar në mosfunksionimin e Këshillit u identifikuan dhe adresuan. Problemi kryesor për mosfunksionalizimin e Këshillit ishte mungesa e qartësisë së ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiave brenda Këshillit, dhe më e rëndësishmja, mungesa e fondeve të cilat do të mund të mbështesin funksionalizimin e tij. Sipas një analizë të publikuar nga ECMI Kosova në atë kohë, për shkak të mungesës së fondeve, Këshilli nuk ka pasur mundësi të zhvillojë asnjë projekt që lidhet me statusin e garantuar me Kushtetutë, dhe fondet ekzistuese ishin vetëm për të mbuluar shpenzimet operative të takimeve dhe grupeve punuese të Këshillit.³⁰ Për periudhën 2015 – 2016, OSBE-ja ka bërë publikimin e një raporti më të detajuar në lidhje me performancën dhe ndikimin e Këshillit. Ndër të gjeturat tjera, OSBE-ja ka gjetur se vetëdija e institucioneve të nivelit lokal në lidhje me ekzistencën dhe funksionin e Këshillit është shumë e ulët, ku 2/3 e të intervistuarve nuk kanë qenë fare në dijeni për Këshillin dhe rolin e tij.³¹ Në mungesë të promovimit me qëllim të ngritjes së vetëdijes për ekzistencën e Këshillit, pjesërisht të lidhur me mungesën e fondeve, dhe mungesën e arritjes deri tek komunitetet, raporti gjithashtu nxorri që angazhimi i Këshillit në përpilimin dhe dorëzimin e rekomandimeve ka qenë në nivel të ulët dhe ka shumë hapësirë për përmirësim kur flasim për bashkëpunimin ndër-institucional. Në fund, edhe pse OSBE-ja vlerësoi Këshillin për arritjen e objektivave të përcaktuar në lidhje me rishikimet e ligjeve relevante, numri i ulët i rekomandimeve të përpiluara dhe dorëzuara bën që kontributi apo ndikimi i Këshillit të vlerësohet i limituar.³² Në dhjetor të vitit 2017, Presidenti i Kosovës Z. Hashim Thaçi ofroi mbështetjen e tij përmes një interviste, për rritjen graduale të buxhetit të Këshillit, ndërsa gjithashtu pranoi rëndësinë e institucionit për mirëqenien e komuniteteve. E gjithë kjo deklaratë ndodhi përpara përvjetorit dhjetëvjeçar të themelimit të Këshillit, i cili do të jetë në vitin 2018.³³ Këshilli cilësohet si trup veçanërisht i rëndësishëm për krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të institucioneve në nivel qendrorë dhe qytetarëve, me dobësitë evidente në ndikimin e kënaqshëm të tij që vihen në pah në problemet që ekzistojnë në mes të legjislacionit dhe zbatimit të tij në lidhje me të drejtat e komuniteteve në Kosovë në përgjithësi. Siç do të bëhet e qartë në këtë raport, problemet e njëjta në zbatim, e shtyjnë zhvillimin e programeve të trajnimit për nënpunësit civil në çështjen e të drejtave të komuniteteve, fakt ky që ndoshta është i lidhur me situatën e institucioneve siç është Këshilli, i cili nuk ka mundësi të përfaqësojë dhe prezantojë komunitetet në mënyrë adekuatë në nivelin shtetërorë.

Në intervistë që është zhvilluar me udhëheqësin e Këshillit, Z. Gazmen Salijević, gjithashtu anëtarë i organizatës ECMI Kosova, ai ndau disa mendime në lidhje me trajnimin dhe edukimin e nënpunësve civil në lidhje me të drejtat e komuniteteve.³⁴ Për shkak të fondeve të limituara, Këshilli deri tani ka organizuar trajnime vetëm për anëtarët e tij. Mirëpo, sipas Z. Salijević, ky trup mund të angazhohet të organizojë trajnime për nënpunësit civil, edhe pse nuk e ka në mandate, vetëm nëse buxheti vjetor do të i rritet. Trajnimet mund të përfshijnë: legjislacioni që mbron dhe promovon të drejtat e njeriut, seanca për ngritjen e kapaciteteve dhe kampanja informuese në lidhje me të drejtat e komuniteteve; dhe organizimin e debateve, ligjeratave dhe punëtorive për përfaqësuesit e shoqërisë civile. Megjithatë, roli i Këshillit mbetet kryesisht për të vepruar si një kanal komunikimi në mes të qytetarëve dhe Qeverisë dhe si i tillë, Këshilli merr ankesa për shkeljen e të drejtave të komuniteteve, dhe i adresojnë këto shkelje me anë të rekomandimeve dhe kërkesave të ndryshme.

³⁰ Buletini informative I ECMI Kosovës. 2013. Mungesa e buxhetit të alokuar dëmton ëndë punën e KKK. <https://us6.campaign-archive.com/?u=0e3bc8a45806bf65531105c4b&id=dad1ff692e&e=26afd14725>

³¹ OSBE. Performanca dhe ndikimi I KKK, 2015-2016, fq. 9

³² ibid. 17-18

³³ Zyra e Presidentit – KKK, Artikull, 21 dhjetor 2017 'Presidenti Thaçi ka diskutuar me KKK për mbrotjen e të drejtave të komuniteteve. <http://www.ccc-rks.net/index.php/en/news/item/549-press-release-december-21-2017>

³⁴ Intervista me Z. Salijević e bërë me datën 19 prill 2018.

Problem kryesor që Z. Salijević e ka identifikuar përgjatë angazhimit të tij deri tani, është kualiteti i dobët i programeve të trajnimit për nënpunësit civil në përgjithësi, dhe specifikisht dobësitë për të identifikuar dhe adresuar çështjet e diskriminimit në bazë të entisë, dhe mbrojtje e dobët e të drejtave themelore të garantuara në Kosovë. Në shumë raste, nënpunësit civil kanë shprehur mosbesimin e tyre në nevojën e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, duke u shprehur që “ata (komunitetet) kanë shumë më shumë të drejta”, thotë ai. Për të, vetëm përpjekjet dhe puna e përbashkët mund të kontribuojnë në përmirësimin gradual, përderisa Këshilli mund të vazhdojë me projektet e tij për informimin e shoqërisë civile për të drejtat e tyre dhe për të ushtruar presion ndaj Qeverisë për problemet e vazhdueshme, barazinë, trajnimet e nënpunësve civilë, llogaridhënien Qeveritare dhe monitorimin institucional, të cilat mund të sigurojnë rezultate afatgjata.

Zyra e Komisionerit për Gjuhët

Zyra e Komisionerit për Gjuhët funksionon në kuadër të zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Që nga vitit 2012, kur kjo zyrë u themelua, mision të vetëm kishte të monitorojë zbatimin e Ligjit për Gjuhët nga institucionet e Kosovës. Kompetencë kryesore e kësaj zyre është: monitorimi i zbatimit të ligjit nga çdo institucion nën juridiksionin e tij; mbledhja e kërkesave/ankesave me iniciativë të ZKGJ apo të dërguara nga personat juridik apo fizik lidhur me mosrespektimin e Ligjit për Gjuhët apo ndonjë akti tjetër nënligjorë nga ndonjë institucion në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare ose gjuhës së ndonjë komuniteti e cila nuk është zyrtare; të ofrojë, kur është e nevojshme, këshilla apo asiston publikun apo institucionet përgjegjëse për obligimet që ata kanë për zbatimin e Ligjit për Gjuhët.³⁵ Në kuadër të ZKGJ, dy (2) mekanizma mbështetës janë themeluar 1) Bordi i Politikave të Gjuhëve i cili vepron si forum për politikat gjuhësore dhe 2) Rrjeti i Politikave Gjuhësore i cili siguron që institucionet të caktojnë një zyrtarë përgjegjës me të cilin Zyra e Komisionerit për Gjuhët do të bashkëpunojë për zbatim më të mirë të politikavë për përdorim të gjuhëve.³⁶

ECMI Kosova, e ka dërguar në mënyrë elektronike pyetësonin tek zyrtarët e kësaj zyre me qëllim për të kuptuar më shumë rreth programeve të trajnimeve që kjo zyrë ka organizuar dhe zhvilluar me përfaqësues të komuniteteve në lidhje me Ligjin për Gjuhët, dhe ka mbajtur një intervistë me Komisionerit për Gjuhët, Z. Slavisa Mladenovic. Sipas të dhënave që li kemi mbledhur, kjo zyrë ka mbajtur trajnime që kanë pasur të bëjnë me komunitetet në Kosovë, të cilat për program kishin komponentën gjuhësore apo Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Nga të gjeturat nga pyetësonët, ZKGJ ka trajnuar nënpunësit civil në dy (2) raste ku si temë kanë qenë: 1) të drejtat Gjuhësore dhe 2) Ligji për Përdorimin e Gjuhëve.

Sa l përket metodologjisë së përdorur në këto trajnime, ZKGJ e ka konsultuar “Udhëzuesin për Nënpunësit Civil në Zbatimin e të drejtave Gjuhësore”, i cili është punuar në bashkëpunim të ngushtë me IKAP-in dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë. Ky dokument ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së nënpunësve civil në lidhje me çështjen e përdorimit të gjuhëve në administratën publike, e cila mund të bëhet përmes moduleve të trajnimit të ofruar nga IKAP-i. Problemet dhe sfidat me të cilat është përballur administrata publike dhe nënpunësit civil janë në lidhje me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Si rezultat, ky dokument është përpiluar me qëllim që të përdoret për organizimin e trajnimeve për nënpunësit civil në lidhje me obligimet e tyre për zbatimin e Ligjit, të cilat do të kontrobojnë në përmirësimin e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve, gjithashtu dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut (duke përfshirë të drejtat gjuhësore).

³⁵ <http://www.komisioneri-ks.org/?page=1,33>

³⁶ <http://www.komisioneri-ks.org/?page=1,61>

Gjatë intervistës, Z. Mladenovic shpjegoi që ZKGJ ka zbatuar dhjetë (10) module në kuadër të programeve të trajnimit të përpiluara nga IKAP-i. Puna me IKAP-in në futjen e nën-moduleve që kanë të bëjnë me gjuhët në programet e trajnimeve, ka filluar në vitin 2016 dhe ka zgjatur për dy (2) vite. Sipas Z. Mladenovic trajnimet që shtjellojnë çështjen e përdorimit të gjuhëve, duhet të jenë të prezantuara në module të vecanta në mënyrë që të arrijnë efektin e kënaqshëm, kështu që, shpreson që në të ardhmen IKAP-i do të trajtojë këtë çështje si të veçantë në çdo trajnim të këtij institucioni.

ZKGJ ka organizuar dy (2) sesione të trajnimit në bashkëpunim me OSBE-në për anëtarët e Rrjetit të Politikave Gjuhësore. Për këto trajnime, trajnerët janë pregaditur paraprakisht nga një ekspert i jashtëm nga Kanada në një punëtorë dy-ditore që është mbajtur në Budvë, e cila gjithashtu është organizuar nga OSBE-ja. Për më tepër, ZKGJ ka mbajtur disa trajnime/kurse në bashkëpunim me ECMI Kosovën ndër vite.

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) ka për qëllim të mbrojë të drejtat e komuniteteve duke përfshirë edhe të drejtën për të u kthyer, siç definohet në Artikullin 3 dhe 4 të Kushtetutës së Kosovës. Mandati i kësaj zyre mbulon këto aktivitete:

- Krijimin e kushteve të favorshme për një proces të qëndrueshëm kthimi duke promovuar besim, dialog, dhe pajtim ndërmjet komuniteteve me anë të strategjive dhe programeve të ndryshme; dhe
- Sigurimim që politikat në nivel qendrorë dhe lokal përmbajnë dispozita që mbrojnë të drejtat e komuniteteve, të drejtat e njeriut dhe interesat e të kthyerve, duke përfshirë edhe lirinë e lëvizjes, përdorimin e gjuhëve të komuniteteve, lirinë e shprehjes, përfaqësim të barabartë, qasje në gjyqësor, të drejtë të banimit, dhe shërbimet lokale.

Për fat të keq, ne nuk morrëm asnjë përgjigje nga kjo zyrë në pyetësorët që ju kemi përcjellur me email. Megjithatë, në disa përgjigje që i kemi marrë nga komunat, mund të themi që MKK ka organizuar punëtorë në lidhje me çështjen e të kthyerve me zyrtarë komunal të cilën punojnë në Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthyerit

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës i cili vepron si mbrojtës i të drejtave dhe interesave të komuniteteve në procesin legjislativ. Ky Komision përbëhet nga anëtarët e Kuvendit të cilët kanë vendet e rezervuara apo të garantuara nga komuniteti Serb dhe komunitetet e tjera jo-shumicë dhe komuniteti shumicë. Ky Komision, shqyrton dhe jep rekomandime duke u bazuar në të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe mund të propozojë ligje të cilat adresojnë çështjet që prekin interesat e komuniteteve.

Ne e kemi kontaktuar me anë të email-it Znj. Natasha Prica, udhëheqëse e këtij Komisioni, duke i drejtuar pyetësorin në lidhje me programet e trajnimit që janë mbajtur për zyrtarë e komuniteteve në nivel qendrorë. Më tepër, ne kemi kërkuar të takohemi me të që të flasim më gjërësisht rreth programeve të trajnimit që janë organizuar apo do të organizohen për zyrtarët në institucionet publike me temën të drejtat e njeriut. Znj. Prica ka kthyer përgjigje, duke sygjyerar të takohemi me Znj. Besa Pajaziti, Zyrtare E Lartë e Trajnimeve në Kuvendin e Kosovës. Në takim, Znj. Pajaziti

theksoi që në çdo fundvit, të gjitha drejtoritë i dërgojnë listën e trajnimeve të nevojshme për nënpunësit civil, mirëpo, deri sot, asnjë prej këtyre programeve të kërkuara nuk kishte të bënte me të drejtat e njeriut. Më tepër, Znj. Pajaziti tha që nga viti 2013, nuk ka pasur asnjë tajnim për të drejtat e njeriut në përgjithësi. Në pyetjet tona, nëse ajo mendon që këto trajnime duhet të mbahen veçanërisht për zyrtarët nga komunitetet, ajo u përgjigj që aty janë dhjetë (10) zyrtarë nga komunitetet, mirëpo ata kurrë nuk kanë kërkuar ndonjë trajnim në lidhje me të drejtat e njeriut apo komuniteteve.

Administrata Publike në nivel Qendrorë

Kërkesës së ECMI Kosovës për të pasur qasje në dokumentat publike, i u janë përgjigjur vetëm disa institucione. Si pjesë e grupit të targetuar, ne kemi pasur çdo Ministri të Kosovës. Kjo kërkesë është dërguar në fromë të pyetësorit (shiko Annex I). Ju lutem shikoni më poshtë tabelën me detaje më të hollësishme në lidhje me organizimin e programeve të trajnimit nga Ministrinë e linjës, sipas përgjigjeve të marra.

Tabela 1. Përgjigjet nga zyrtarët përgjegjës nga Ministrinë

KËRKESA TEK INSTITUCIONI	DATA E KËRKESËS	DATA E KTHIMIT TË PËRGJIGJES	PËRGJIGJJA E MARRË
Ministria e Forcës dhe Sigurisë	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Infrastrukturës	7/10/2018	7/20/2018	Përgjegjëse për organizim të trajnimeve është IKAP.
Ministria e Financave	7/10/2018	7/20/2018	Zyrtari për Komunitete dhe të drejtat e fëmijëve në kuadër të MF tha që nuk ka qenë kurrë pjesë e një trajnim të këtij lloji por kishte dashur që të jetë, dhe tha që nëse këto trajnime organizohen, të l dërgojmë ftesën për pjesëmarrje. Disa departamente të MF siç janë ai i buxhetit, tatimit në pronë, departamenti qendror për partneritet publiko-privat, e të tjera, kanë organizuar trajnime ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të komuniteteve. Në Ministri, është një zyrtarë nga radhët e komuniteteve që l ka ndjekur të gjitha trajnimet e lartpërmendura.
Ministria e Shëndetësisë	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Integriteteve Evropiane	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur

Ministria e Drejtësisë	7/10/2018	7/18/2018	Divizioni i Burimeve Njerëzore, në koordinim me IKAP-in, cakton nëpunësit civil të Ministrisë së Drejtësisë të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga IKAP-i, varësisht nga fusha profesionale që përmban trajnimi. Në rast se në këto trajnime caktohen të marrin pjesë përfaqësues të komuniteteve, IKAP-i njoftohet në mënyrë që të ofrojë përkthim në gjuhën adekuate. Trajnimet organizohen për të rritur kapacitetin e nëpunësve civil, në bazë të detyrave të tyre që i kanë të përshkruara në kontratë.
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë		----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Punëve të Brendshme	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Punëve të Jashtme	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor		----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Diasporës dhe Investime Strategjike	7/10/2018	7/19/2018	Nuk kanë marrë pjesë dhe nuk kanë organizuar trajnime në fushë e të drejtave të komuniteteve.
Ministria për Komunitete dhe Kthim	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	7/10/2018	7/20/2018	Ka organizuar trajnime në bashkëpunim me OSBE-në në komuna ku pjesëmarrës ishin pjesëtarë të komunitetit Rom dhe fushat e shtjelluara ishin: trafikimi i qënieve njerëzore, personat lypsarë të rrugëve, lindja e fëmijëve dhe rëndësia e shkollimit/arsimit. Trajnimet ishin financuar nga Divizioni për të Drejta të Njeirit në MAPL dhe OSBE. Pjesëmarrë në këto trajnime, ishin qytetarë të komunitetit Rom, zyrtarë komunal duke përfshirë edhe zyrtarë që punojnë në ZKKK. Trajnerët e keqytare trajnimeve ishin pregaditur paraprakisht nga ekspertë të jashtëm dhe MAPL.
Ministria e Administratës Publike	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Agrikulturës, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur
Ministria e Zhvillimit Rajonal	7/10/2018	7/11/2018	Si Ministri e re, janë ende duke u marrë me organizim të brendshëm dhe nuk kanë organizuar ende ndonjë trajnim me temë specifike siç është komunitetet në Kosovë.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	7/10/2018	----	Nuk është përgjigjur

Niveli Lokal i Kosovës

Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)

Të gjithave komunave të Kosovës u kërkohet të kanë funksionale Zyrën për Komunitete dhe Kthim. Këto zyra kanë për qëllim të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve, të sigurojnë që të gjithë kanë qasje të barabartë në shërbimet publike, gjithashtu të krijojnë kushte të mira për të kthyerit të integrohen, duke u fokusuar tek të kthyerit dhe të riatdhesuarit që u përkasin komuniteteve.³⁷ ECMI Kosova ka organizuar takime me përfaqësues të ZKKK-ve në katërmbëdhjetë (14) komuna ku është aktive me projektin ERAC, me anë të asistentëve/asistenteve ligjorë/ligjore. Sipas informatave që i kemi marrë nga këto takime, ZKKK-të nuk organizojnë trajnime për departamente apo zyre tjera në komuna në lidhje me të drejtat e komuniteteve apo të kthyerve.

³⁷ <http://www.ecmikosovo.org/en/Municipal-Level-Institutions>

Njësitë Komunale për të drejtat e njeriut

Sikurse ZKKK-të, të gjitha komunat janë të detyruara të kenë Njësitë Komunale për të drejtave të njeriut (NjKDNj). NjKDNj, përveç monitorimit të të drejtave tjera të njeriut, fokusohet edhe tek të drejtat e komuniteteve dhe zbatimi i Ligji për Gjuhët dhe përdorimi i gjuhëve siç e garantuar me Kushtetutë dhe ligjet relevante. NjKDNj-të janë gjithashtu përgjegjëse për të adresuar kërkesat e qytetarëve të komunës në fjalë në lidhje me të drejtat e njeriut.³⁸

Komiteti Komunal për Komunitete

Komiteti për Komunitete (KK) është një nga tre (3) Komitetet që çdo komunë duhet të e themelojë duke e marrë parasysh Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ përkatës (MAPL) Nr. 03/2014. KK është themeluar si mekanizëm për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mbrojtjen e komuniteteve i cili siguron që çdo komunitet lokal, pavarësisht madhësisë, gjuhës, fesë, etnicitetit apo ndonjë karakteristike tjetër dhe anëtarët e tyre duhet të marrin trajtim të barabartë nga autoritetet lokale.³⁹

KK është përgjegjëse për promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe identifikon shkeljet që u bëhen komuniteteve; përpilon rekomandime dhe dorëzon tek Kuvendi Komunal respektiv; dhe shqyrton të gjitha politikat komunale, praktikat dhe aktivitetet në mënyrë që të sigurojë që të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen siç të garantuara. Gjithashtu, KK mbron dhe zhvillon identitetin etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësorë si dhe siguron mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve. Ky Komitet, ka edhe përgjegjësi tjera, vetëm nëse thuhet ndryshe në Statusin e Komunës përkatëse.⁴⁰ Në fund, KK nuk organizon trajnime në kuadër të vet, pasi që funksionon kryesisht si një trup mbikqyrës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.

Institucionet e Pavaruara

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës

Avokati i Popullit i Kosovës ka kompetencën për të hetuar ankesat e marra nga çdo person fizik ose juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, ligjet dhe aktet e tjera, si dhe të Drejtat e cekura në Konventat Ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë. IAP paraqet mekanizmin ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Kosovë, si dhe vepron si Mekanizëm Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjithashtu, Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, të cilat ligje, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore të të drejtave të njeriut, e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015.

³⁸ Ibid.

³⁹ <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/305531?download=true>

⁴⁰ http://prishtinaonline.com/uploads/komiteti_per_komun..pdf

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Kosovë. Si institucion i pavarur, udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Në intervistë me Znj. Merita Syla, Drejtoreshë e Departamentit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ne kemi diskutuar rreth trajnimeve të organizuara dhe mbajtura nga IAP-i në përgjithësi dhe në veçanti të dedikuara për komunitetet. Sipas Znj. Syla, IAP organizon trajnime të shumta dhe të shpeshta për stafin që punon në këtë institucion, duke e marrë parasysh që është shumë e rëndësishme për stafin e këtij institucioni të jenë të informuar detajisht për çështje të ndryshme. Trajnimet për stafin financohen nga institucioni vet, mirëpo vlen të përmendet edhe mbështetja e herëpashershme e donatorëve të ndryshëm. Përveç trajnimeve për stafin, IAP-i ka trajnuar dhe certifikuar stafin si trajnerë që mund të angazhohen nga institucione të ndryshme në çështje të caktuara.

Znj. Syla ka qenë pjesëmarrëse në trajnime që si teme kishin çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin LGBTI, gjykatës, policinë, qendra për punë sociale, konsulencë ligjore e kështu me radhë.⁴¹ Detaje më të hollësishme për trajnimet që kanë të bëjnë specifikisht me çështjet që prekin komunitetet mund të gjindet në raportin e tyre vjetor 2017.⁴² Për më tepër, Znj. Syla theksoi që trajnimet për nënpunësit civil janë të rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil, i cili obligon institucionet publike të investojnë të ngrisin kapacitetet e stafit të tyre. Ajo gjithashtu tha që IKAP-i nuk ka qenë shumë efektiv në ofromin e trajnimeve adekuata në çështjen e të drejtave të njeriut, e aq më pak në të drejtat e komuniteteve.

Administrata Publike në Nivel Lokal

Në kërkesën e ECMI Kosovës për të pasur qasje në dokumentat publike në institucionet në nivel lokal, ne kemi marrë mjaft përgjigje. Institucionet e targetuara ishin të gjitha komunat e Kosovës. Kërkesa është dërguar në formë të pyetësorit (shiko Annex 1). Ju lutem shikoni tabelen 2 për më shumë informata për trajnimet e organizuara nga komunat, nga përgjigjet që i kemi marrë.

⁴¹ Interview with Ombudsperson Institution of Kosovo, Ms. Merita Syla, July 2018.

⁴² <https://oik-rks.org/en/2018/03/30/annual-report-2017/>

Tabela 2. Përgjigjet nga zyrtarët Komunal.

KËRKESA PËR INSTITUCIONIN (KOMUNËN)	DATA E KËRKESËS	DATA E KTHIMI TË PËRGJIGJES	PËRGJIGJJA E MARRË
Deçan	10/07/2018 20/07/2018	20/07/2018	Komuna nuk ka trajnime për komunitete sepse këto trajnime organizohen nga niveli qendrorë. Në trajnimet zyrtare marrim pjesë duke u bazuar në njoftimet që bëhen nga niveli qendrorë në çështjet e caktuara. Komuna drafton planet e trajnimit, të cilat më pas dërgohen tek MAP në nivelin qendrorë. Në këtë draft, komuna specifikon fushat dhe temat për të cilat mendon që duhet të organizohen trajnime për nënpunësit civil. Ne nuk kemi pasur asnjë trajnim I cili ka prekur fushën e komuniteteve. Kjo temë nuk është ngritur asnjëherë nga nënpunësit civil në komunë, apo nuk është sygjëruar nga trajnimet e organizuara nga MAP apo ndonjë institucion tjetër I nivelit qendrorë.
Dragash	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Drenas	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Ferizaj	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Fushë Kosovë	10/07/2018 27/08/2018 12/09/2018	-	Nuk është përgjigjur
Gjakova	10/07/2018	18/07/2018	ZKKK organizon trajnime dhe shënon ditë me qëllim të ngritjes së vetëdijes për të drejtat e komuniteteve për nënpunësit civil dhe për qytetarët në përgjithësi. Kampanjat zakonisht fokusohen në shkolla dhe mësimdhënës dhe kanë si temë trajtimin e barabartë të fëmijëve pavarësisht etnicitetit të tyre. Trajnimet të cilat organizohet dhe shtjellojnë çështjet e komuniteteve zakonisht organizohen nga Ministritë e ndryshe dhe i u dedikohen nënpunësve civil.

Gjilan	10/07/2018	23/07/2018	Trajnimet ishin organizuar nga MKK, MAPL dhe organizatat ndërkombëtare. Temat në këto trajnime ishin këto: rishikimi i Kushtetutës dhe ligjeve relevant që prekin të drejtat e komuniteteve, Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative gjithashtu janë diskutuar dhe janë përmendur përgjegjësitë e nënpunësve civil në implementimin e tyre. Zakonisht, nënpunësit civil që punojnë në ZKKK marrin pjesë në këto trajnime. Kjo është e rregulluar dhe e cekur në mandatin e tyre.
Graçanicë	13/07/2018 02/08/2018 12/09/2018	13/09/2018	Nënpunësit civil kanë marrë pjesë në trajnimet që kanë pasur focus të veçantë tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Temat e këtyre trajnimeve kanë pasur për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre komuniteteve. Më tepër, gjithashtu trajnime me qëllim të identifikimit të formave se si të mbrojmë dhe promovojmë këto të drejta janë organizuar.
Hani i Elezit	10/07/2018 23/07/2018	23/07/2018	Në komunën e Hanit të Elezit, duam të ju njoftojmë që 99.9% e banorëve janë të komunitetit shumicë kështu që nuk kemi pasur asnjëherë organizime të trajnimeve të këtij lloji.
Istog	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Junik	13/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Kaçanik	13/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Kamenicë	10/07/2018	24/07/2018	Në komunën e Kamenicës, asnjë nënpunës civil nuk ka qenë pjesë e ndonjë trajnime me temën të drejtat e njeriut apo më specifikisht të drejtat e komuniteteve, kështu që ne mendojmë që trajnime me këtë temë duhet të organizohen dhe janë shumë të nevojshme.

Klinë	10/07/2018 23/07/2018	23/07/2018	<p>Ju njoftojmë që nga të dhënat që i kemi marrë nga ZKKK, gjatë vitit 2018, disa trajnime janë organizuar nga këto organizata:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ GIZ; ▪ USAID me temën “Ngritja e kapaciteteve në arsimin fillorë”; ▪ USAID me temën “Trajnim për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale”; <p>USAID me temën “Menaxhim I Projektit”. Ne mendojmë që trajnime të ngjashme janë shumë efektive dhe të nevojshme për përmirësimin e shërbimeve që u ipet komuniteteve. Ne nuk kemi të dhëna për trajnimet e mbajtura gjatë vitit 2017 pasi që në pozitë të drejtorit të administratës në komunë jam që nga janari i vitit 2018.</p>
Kllokot	13/07/2018 16/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Leposavic	13/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Lipjan	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Malishevë	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Mamushë	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Mitrovica Veriore	13/07/2018 30/08/2018 12/09/2018	-	Nuk është përgjigjur
Mitrovicë	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Novobërdë	13/07/2018 06/09/2018	06/09/2018	<p>Disa trajnime janë mbajtur mirëpo nuk kanë qenë specifike vetëm për të drejtat e komuniteteve apo të drejtat e njeriut. Trajnimet janë organizuar nga institucionet e nivelit qendrorë, shpesh në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare të cilat janë në Kosovë. Disa nga trajnimet ishin për të drejtat gjuhësore dhe si të e trajtojmë konfliktet ndër-etnike.</p>
Obiliq	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Partesh-Pasjan	13/07/2018	28/07/2018	<p>Asnjë trajnim nuk është organizuar nga institucionet e qeverisë së Kosovës përveç një (1) trajnim është organizuar nga IAP i cili kishte për qëllim shqyrtimin e Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë.</p>

Pejë	10/07/2018	18/07/2018	ZKKK ka marrë pjesë në disa trajnime të cilat janë organizuar për nënpunësit civil apo vetëm specifikisht për zyrtarët që punojnë në ZKKK. Mirëpo, asnjë trajnim nuk është organizuar me temë të veçantë për të drejtat e komuniteteve apo të drejtat e njeriut.
Podujevë	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Prishtinë	10/07/2018 23/07/2018 12/09/2018	12/09/2018	Janë organizuar disa trajnime nga IKAP. Komunitetet dhe të drejtat e tyre ishin pjesë e një programi të trajnimit më të gjërë i cili ishte për kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës. Trajnimet nuk organizohen në mënyrë të vazhdueshme, mirëpo duke u bazuar në ndonjë ligj apo udhëzim administrative të ri i cili prek punën e nënpunësve civil.
Prizren	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Rahovec	10/07/2018 13/07/2018 02/08/2018	-	Nuk është përgjigjur
Ranillug	13/07/2018	02/08/2018	Komuna nuk ka organizuar ndonjë trajnim të këtij lloji mirëpo nëse organizohet ndonjë trajnim me mbështetjen tuaj, me shumë dëshirë kishim marrë pjesë.
Shtërpçë	13/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Shtime	10/07/2018	24/07/2018	Në komunën e Shtimes nuk kemi pasur asnjë trajnim për çështje të komuniteteve të organizuar nga ndonjë organizatë. Ka pasur disa organizime të kampanjave të ndryshme kohë pas kohe mirëpo asnjë program specifik për këtë çështje. ZKKK ka mbajtur disa takime me përfaqësues të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe i ka informuar ata për të drejtat e tyre në fusha të caktuara. Sesionet e takimeve mund të themi që kanë kontribuar në përmirësimin e shërbimeve nga Qendrat për Punë Sociale (QPS), Qendrat e Mjeksisë Familjare (QMF), Administrata e kështu me radhë. Gjithashtu, ndikim pozitiv ka pasur në përpilimin e Planit të Punës për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në komunë.

Skenderaj	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Suharekë	10/07/2018 23/07/2018	26/07/2018	Përfaqësuesit e ZKKK kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga ZQM. Tema e këtyre trajnimeve ishte çasja në dokumenta publike dhe e drejta për marrjen e informatave në gjuhët zyrtare të Kosovës.
Viti	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Vushtrri	10/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Zubin Potok	13/07/2018	-	Nuk është përgjigjur
Zveçan	13/07/2018	-	Nuk është përgjigjur

V. ZBATIMI I LIGJIT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)

KGJK⁴³ dhe KPK⁴⁴ veprojnë si institucione të pavarura me qëllim të sigurojnë pavarësinë, drejtësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin e sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë. Në intervistë të realizuar nga ekipi i angazhuar në këtë hulumtim, Znj. Ganimete Juniku⁴⁵ nga KGJK deklaroi se as KGJK as KPK nuk kanë ndonjë program të trajnimeve që organizojnë në mënyrë të pavarur, megjithatë thekson që të dy institucionet kanë një bashkëpunim të ngushtë me Akademinë e Drejtësisë, që është përgjegjëse për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Së bashku ata punojnë në programet e trajnimit për të i bërë ato sa më gjithëpërfshirës që është e mundur, në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe kornizën ligjore të Kosovës, si dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat janë zbatueshme në Kosovën.

Sipas Znj. Juniku, të dy institucionet, KGJK dhe KPK, kanë trajnerë të certifikuar që institucionet, veçanërisht Akademia e Drejtësisë, i fton të mbajnë trajnime të kësaj fushe, shpesh të organizuara dhe mbështetura nga donatorët siç janë organizatat ndërkombëtare në Kosovë.

Gjyqësori

1.1.1 Instituti Gjyqësor i Kosovës, aktualisht Akademia e Drejtësisë

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) filloi aktivitetet si organ i pavarur i themeluar nga OSBE-ja në gusht të vitit 1999 fillimisht si "Seksioni i Trajnimit Gjyqësor", ku më pas në vitin 2000 edhe u zyrtarizua si IGJK.⁴⁶ Në vitin 2006, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin "Për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës" dhe përcaktoi si përgjegjësi të IGJK-së koordinimin e këtij institucioni me atë të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJK) dhe entitetet tjera pasardhëse për trajnimet që janë të nevojshme për gjyqtar, prokurorë dhe kandidatë për këto pozita si dhe pozitat mbështetëse mbrenda sistemit Gjyqësor të Kosovës.⁴⁷ Të përfshira në programet e trajnimit të IGJK-së që prej fillimit të funksionimit të këtij instituti, kanë qenë seminare, simpoziume, sesione të trajnimeve dhe punëtori që kanë trajtuar çështjet nga më të ndryshmet duke filluar nga të drejtat e njeriut deri tek çështjet ligjore specifike dhe marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe zbatimit të ligjit.⁴⁸

Në lidhje me skemën "Programi i Vazhdueshëm i Trajnimit" i cili ka pasur për qëllim të ofrojë zhvillim profesional për gjyqtarët dhe prokurorët, pesë (5) nga 115 kurset janë fokusuar tek "Barazia gjinore dhe diskriminimi". Numri më i madhë i trajnimeve, apo 38 prej tyre, ishin fokusuar në "Fushën e Kriminalistikës (procedurat)", dhe me i vogël, apo një (1) session i trajnimit në "Udhëheqësia e qëndrueshme".⁴⁹ Pjesëmarrja demografike e këtyre trajnimeve sipas regjistrimeve është nga numri i përgjithshëm i të trajnuarve që është 1,555, 1527 prej tyre ishin të komunitetit Shqiptarë, 17 nga minoritetet (të paspecifikuar se nga cili komunitet skatësisht) dhe 11 ishin ndërkombëtarë.⁵⁰

⁴³ <http://www.gjyqesori-rks.org/en/>

⁴⁴ <http://www.kpk-rks.org/en/>

⁴⁵ Intervistë me Znj. Ganimete Juniku, Zyrtare e Lartë, Departamenti Ligjorë, KGJK, gusht 2018.

⁴⁶ Misioni i OSBE-së në Kosovë. Maj 2002. IGJK, fq. 1

⁴⁷ Kuvendi i Kosovës. 23 shkurt 2006. Ligji nr. 02/L-25, "Themelimi i Institutit Gjyqësor i Kosovës", Artikulli 1, Paragrafi 1.7, 1.8.

⁴⁸ Misioni i OSBE-së në Kosovë. Maj 2002. IGJK fq. 1, 2

⁴⁹ ibid. p. 26

⁵⁰ ibid. p. 27

Kur është fjala tek trajnimet për të drejtat e njeriut, gjatv vitit 2015, IGJK ka ofruar gjashtë (6) sesione të trajnimit në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të cilat u fokusuan në mbrojtjen e të dhënave, burimet e informative për gazetarë, standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e dëshmitarëve, e drejta e gjyqimit të barabartë duke u bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe çasja në dokumenta publike.⁵¹ Në pajtueshmëri me qëllimet strategjike të IGJK për arritjen e standardeve të BE-së dhe ndërkombëtarë, gjashtë (6) trajnime të veçanta janë organizuar dhe dedikuar për barazinë gjinore dhe diskriminimin, me focus të veçantë në mbrojtjen e diversitetit, tolerancës dhe barazisë, si dhe kuptim më i gjërë se si paragjykimet janë krijuar dhe si ato ndikojnë.⁵² Edhe pse jo e cekur në mënyrë specifike, raporti i OSBE-së thekson që fushat e fokusit të aktiviteteve të lartpërmendura ishin fokusuar në çështjen gjinore dhe të komunitetit LGBTI.

Në kundërshtim me ombrellën që përmbledhë fushën e të drejtave të njeriut, në raportin e tyre të vitit 2016, të titulluar "Mbrojtja Ligjore nga Diskriminimi në Evropën Jug Lindore", Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), organizatë që bashkëpunon me Qeverinë e Kosovës në fushën e organizimit të trajnimeve për nënpunësit civil, ka marrë në konsideratë dhe ka analizuar diskriminimin në nivel rajonal, rastë të veçanta dhe nivel institucional.⁵³ Në këtë raport, GIZ ka theksuar që në sistemin gjyqësor, përveç faktit që struktura e sistemuar për ndarje të praktikave të mira dhe për të rritur vetëdijen e gjyqtarëve për mbrojtje nga diskriminimi nuk ekziston, kur shohim rastet e veçanta, vërejmë që përshkrimi dhe përdorimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi që ndodhë në mënyrë formale dhe tradicionale shumë shpesh rezultojnë në progres.⁵⁴ Ndoshta e gjetura kryesore e këtij raporti e cekur në mënyrë të vazhdueshme nga GIZ është që ka mangësi në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e diskriminimit në Kosovë, fakt ky që rrezulton tek mungesa e regjistrimit apo mbajtjes së statistikave të rasteve të identifikuara në nivel shtetërorë, i cili është i ndërlidhur me mungesën e trajnimeve të obligueshme që prekin fushën e të drejtave të komuniteteve që organizohen mbrenda programeve të trajnimit të IGJK.

Nga data 24 shkurt 2017, Kuvendi I Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 05/L-95, i cili e ka shëndrruar IGJK në Akademinë e Drejtësisë, duke ju përmbajtur programeve të njëjta të trajnimit dhe planit strategjik.⁵⁵ Në Programin e Vazhdueshëm të Trajnimeve të Vitit 2017 të Akademisë, të drejtat e njeriut ishin të përfshira në sesione të trajnimeve për të mbështetur implementimin e Konvetës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Si rrjedhojë, pjesëmarrësit në një trajnim tre (3) ditorë, u këshilluan në strukturën dhe interpretimin e Konventës Evropiane dhe ndërlidhjen e saj me Kushtetutën e Kosovës, Artikullin 6 Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe zbatimit të tij dhe Artikullin 10 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁵⁶ Një trajnim një (1) ditorë, i u dedikua specifikisht "Mbrojtjes dhe Promovimit të Diversitetit, Tolerancës dhe Barazisë në bazë të Legjislationit për mbrojtje nga Diskriminimi", trajnim ky që u fokusua në diversitetin në shoqëri, diskriminimi dhe ngacmimi, dhe paragjykimet e shoqërisë dhe gjyqësorit. Kjo ditë e trajnimit kishte përmbledhur interpretimin e ligjeve ekzistuese dhe aktivitetet apo ushtrimet që kanë pasur për qëllim ngritjen e vetëdijes për çështjet në fjalë.⁵⁷

⁵¹ ibid. p. 34

⁵² ibid. p. 35

⁵³ Qendra SEELS, 2016. Mbrojtja Ligjore nga diskriminimi në Evropën Jug Lindore: Studim rajonal, fq. 17

⁵⁴ ibid. fq. 260, 263-264

⁵⁵ Dekreti nga Presidenti I Kosovës, 03 shkurt 2017. Ligji Nr. 05/L-95. "Akademia". Shpallur nga dekreti Nr. DL-008-2017.

⁵⁶ Akademia e Drejtësisë së Kosovës. Programi I trajnimit 2017, fq. 91-93

⁵⁷ ibid. fq. 94

Siç shihet qartë, trajnimi për të drejtat e njeriut gjatë vitit 2017, ishte fokusuar në kornizë ligjore të përgjithshme, siç e cekur në KEDNj dhe Kushtetutën dhe legjislacionin e Kosovës, kurse trajnimet e specializuara që kanë shtjelluar diskriminimin në bazë të përditshme, nuk kanë qenë në fokus aq të madhë. Duhet patjetër të theksojmë, prapë, që pjesëmarrja në këto trajnime nuk është e obligueshme dhe nuk ekziston ndonjë mekanizëm i cili përcjellë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin apo regjistron me numra arritjet apo rezultatet e organizimit të këtyre trajnimeve.

Programet e trajnimit të ngjashme, të organizuara për trajnerë, nga ana tjetër, duket që janë fokusuar në teknikat e mësimdhënies dhe metodologjinë arsimore, dhe, çasja e tyre do të përshkruhet në vazhdim.⁵⁸ Stafit administrativ është trajnuar, ndër të tjera, edhe në këto çështje në aspektet teknike të profesionit të tyre: "Menaxhment" (një ditë), "Komunikimi i mbrendshëm dhe jashtëm" (një ditë) dhe "Shkrim dhe arsyetim ligjorë" (një ditë).⁵⁹ I vetmi trajnim relevant që ka prekur fushën e mbrojtjes kundër diskriminimit ka qenë një organizim një (1) ditorë i cili ka prekur temën "Etika dhe Profesionalizmi"⁶⁰ i cili ishte i fokusuar në Kodin e Etikës për stafin, i cili përfshin mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të races/origjinës/gjinisë/seksit si bazë e sjelljes siç e cekur në Artikullin 7. Tema e trajnimit më në hollësi do të prezantohet në pjesën më poshtë të këtij raporti.⁶¹ Cikli vjetor i trajnimeve, 2018 – 2019, "Programi fillestar I trajnimit 2018/2019 për prokurorët e përgjedhur", përmban dhjetë (10) sesione të trajnimeve (30 orë trajnime) dhe shtjellon legjislacionin që prek të drejtat e njeriut sipas KEDNj, ku shihet një përmirësim i qartë me atë të vitit 2016 "Trajnimi Praktik I Programit Fillestarë të Trajnimit" i cili nuk kishte përfshirë sesione të ngjashme.⁶²

Në përgjithësi, për udhërrëfyesin i cili përfshin periudhën 2016 -2019, Qeveria e Kosovës, është zotuar të vazhdojë të ndjekë të gjithë hapat të cilët janë në pajtueshmëri me BE-në kur është fjala për të Drejtat e Njeriut mirëpo trajnimet specifike të cilat fokusohen në fushën e të drejtave të komuniteteve të organizuata në nivel local nuk shihen të jenë në agjendë. Në vijim, do të bëhet analizimi i informative të mbledhura nga trajnerët dhe pjesëmarrësit në programet që kishin focus të veçantë të drejtat e njeriut të organizuara nga Akademia e Drejtësisë, në mënyrë që të kuptojmë se si janë paraqitur të drejtat e komuniteteve dhe barazia.

Vlerësimi i Cilësisë së Trajnimeve ofruar Gjyqësorit

Çështjet të cilat janë prekur në trajnimin për të drejtat e njeriut dhe kundër diskriminimit të Gjyqësorit janë bërë të dukshme gjatë intervistës me Koordinatorin e Programit në Akademinë e Drejtësisë, Z. Besim Morina.⁶³

Edhe pse Z. Morina ka konfirmuar që trajnimet në fushën e të drejtave të njeriut u ofron vërtetë nënpunësve civil, tri (3) pengesa të rëndësishme janë identifikuar të cilat ndikojnë tek shpërndarja e programit të trajnimit. E para, trajnimet janë përpiluar në pajtueshmëri me KEDNj, dhe si të tillë, fokusohen më shumë në teori, legjislacion dhe raste studimore, dhe gjithashtu në lidhjen në mes të ligjeve të Kosovës dhe ndërkombëtare.

⁵⁸ Akademia e Drejtësisë së Kosovës, Programi I Trajnimit, fq. 129-131.

⁵⁹ Akademia e Drejtësisë. Trajnim për Administratën e Menaxhmentit dhe Stafin Administrativ të Gjykatave dhe Zyreve të Prokurorëve, fq. 120-128

⁶⁰ ibid. fq. 127

⁶¹ Këshilli Prokurorial I Kosovës. Kodi profesional i etikës për stafin mbështetës, Artikulli 7 "Anti-diskriminimi" fq. 4

⁶² Akademia e Drejtësisë. Trajnim fillestarë për prokurorët e sapo emëruar, fq. 26-27; Instituti Gjyqësor I Kosovës dhe Institute and Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. 2016. Doracak për praktikantët e trajnimit dhe programet fillestare të trajnimit.

⁶³ Intervista m Z. Morina e bërë më 06 qershor 2018 në zyrën e tij në Akademinë e Drejtësisë.

Edhe pse ka kapituj të veçantë që përfshijnë të drejtat e komuniteteve, Z. Morina theksoi që natyra e sesioneve të trajnimeve nuk është që gjithmonë arrinë rezultate pozitive. Sesionet e trajnimeve janë të strukturuar në atë mënyrë që të ofrojnë hapësirë për gjyqëtar dhe prokurorë të bisedojnë rastet me të cilat ata përballen në punën e tyre të përditshme dhe marrin mendimet ligjore nga kolegët e tyre. Në përgjithësi, prokurorët dhe gjyqëtarët janë të interesuar për të pasur mundësi të jenë pjesë e trajnimeve në lidhje me çështjen ligjore me të cilat ata ballafaqohen në punën e tyre të përditshme, dhe të kenë mundësi të i diskutojnë, kuptojnë dhe analizojnë rastet. Meqë rastet e diskriminimit të komuniteteve dhe mosrespektimi i të drejtave të tyre, nuk janë të raportuara shpesh dhe rrallë herë adresohen tek Gjyqësori, siç vërehet nga shpjegimet e dhëna në raport, rrjedhë që të mos ketë sesione apo programe të trajnimit që shtjellojnë këtë dukuri brenda Akademisë. Problemi bëhet edhe më i madhë tani që, që nga viti 2018, trajnimet për të drejtat e njeirut janë të përfshira në trajnimet “vullnetare” të Akademisë, kurse tek trajnimet e “obliguara” për gjyqëtar dhe prokurorë shtjellojnë vetëm temën mbi etikës.

Fokusi kryesorë i Akademisë është trajnimet i gjyqëtarëve dhe prokurorëve, mirëpo mbas shëndrrimit nga IGJK, ligji I ka dhënë mbandat Akademisë të organizojë trajnime edhe për stafin administrative. Këto trajnime fokusohen kryesosh në ngritjen e kapaciteteve, të cilat planifikohen paraprakisht me gjyqëtarët, dhe shpesh organizohen me mbështetje të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian. Institucionet Ndërkombëtare dhe OJQ-të gjithashtu japin rekomandime për trajnime të reja, mirëpo sipas Z. Morina, shumë shpesh këto ide nuk përputhen me nevojat në teren. Për shembull, vitin e kaluar, Akademia ka organizuar një trajnim ku ka trajtuar Ligjin për Falimentimin. Edhe pse ishte tema e kërkuar nga pjesëmarrësit, asnjë person nuk ishte prezent në ditën e trajnimit. Sigurisht, natyra jo e obligueshme për pjesëmarrje në trajnime është një prej faktorëve që ka ndikim, kështu që është e sygjerueshme që trajnimet që shtjellojnë çështjen e të drejtave të njeirut dhe kundër diskriminimit duhet të bëhet të obligueshme për stafin administrative, gjyqëtarët dhe prokurorët.

Në fund, situatë e njejtë është edhe në Akademinë e Drejtësisë, ku shihet qartë mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional I cili ndikon në analizimin e rasteve të diskriminimit, hap ky I cili mund të ndikojë në ngritjen e çështjeve në mes të gjyqëtarëve dhe prokurorëve si dhe stafit administrativ. Pjesëmarrja në trajnime nuk është e lidhur me rritjen apo vlerësimin profesional të nënpunësve civil, rrjedhimisht, ata nuk kanë ndonjë shtytje për të marrë pjesë. Në përgjithësi duket se qëllimet e mira ekzistojnë, por përkufizimi i paqartë i të drejtave të njeirut, fokusi I trajnimeve tek aspektet ligjore, mungesa e rasteve të raportuara, natyra jo e obligueshme e pjesëmarrjes në trajnime, dhe mungesa e shtytjeve për të marrë pjesë në trajnime, bëjnë që përpjekjet e Akademisë së Drejtësisë të jenë në nivel jo të kënaqshëm të efektivitetit.

Forca Policore e Kosovës

The IPK, IKAP dhe ShShPK

Që nga viti 1999, OSBE-ja ka qenë pjesë e trajnimit për SHPK në bashëpunim me Qeverinë, ku focus të veçantë kanë pasur demokratizimin e forcës policore dhe trajnimin e tyre në fushë e të drejtave të njeirut, përveç fushave tjera.⁶⁴ Në të njejtën kohë, Qeveria e Kosovës ka krijuar në vitin 2011 Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (Ligji Nr. 04/L-053), e cila ka mandate të ofrojë trajnime në bashkëpunim me OSBE-në për zyrtarë e policisë.⁶⁵

⁶⁴ Misioni i OSBE në Kosovë. Mars 2005. Edukimi dhe Zhvillimi I Policisë, Dokument, fq. 1

⁶⁵ Gazeta zyrtare e Kosovës, Nr. 26, 25 nëntor 2011. Ligji N2. 04/L-053. 'Akademia e Kosovës për Siguri Publike' I shpallur na dekreti Nr. DL.-045-2011.

Siç do të shihet më vonë në raport, në vitin 2018, edhe pse OSBE-ja mbetet të jetë institucioni i vetëm i cili punon në ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e policëve të Kosovës në çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet etnike, tani ky institucion ka drejtuar fokusin tek çështjet që kanë të bëjnë me përfshirjen gjinore dhe komunitetin LGBTI, duke e zvogëluar minimalisht fokusin e aktiviteteve që prekin çështjen e komunitetet etnike. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), nga ana tjetër, ka organizuar konferenca dhe punëtori në Ballkanin Perëndimorë, ku të ftuar ishin edhe pjesëmarrës nga Kosova në programe të trajnimit relevante për policinë, mirëpo këto organizime ishin dukshëm minimale. Zyra e saj për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), nga ana tjetër, ka organizuar konferenca dhe punëtori edukative në Ballkanin Lindor, mirëpo pjesëmarrja e Kosovës në programet përkatëse të trajnimit të policisë ishte dukshëm minimale.⁶⁶

Në mes të vitit 1999 dhe 2005, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (KPSS) e udhëhequr nga OSBE-ja, raportoi që rreth 7,000 zyrtarëve të diplomuar, në tetë (8) komuna shumë etnike, u janë ofruar klasa të cilat kishin parime të forta demokratike në fushë e të drejtave të njeriut të përfshira në kurrikulë, program të certifikimit të trajnerëve, dhe një seri e programeve për policë, duke theksuar që lufta kundër krimit, prek shoqërinë në tërësi.⁶⁷ Klasat ishin organizuar në gjuhën Agleze, Shqipe dhe Serbe dhe studentat pjesëmarrës ishin të etnive të ndryshme ku 84% ishin Shqiptarë të Kosovës, 10% Serb të Kosovës dhe 6% të tjerë (Rom, Turk, Goran, Boshnjak dhe sllavë musliman).⁶⁸ Vitin në vijim (2006), në koordinim me IPV MPB, Inspektorati I Policisë së Kosovës (IPK) u inagurua, trup ky i cili ishte themeluar të sigurojë që policia të mbajë përgjegjësi ndaj njerëzve që ju shërben dhe që siguron të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët.⁶⁹

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Departamenti i Zbatimit të Ligjit brenda OSBE-së, u përball me një rënie të konsiderueshme të policëve të komunitetit Serb, pasi që ata larguan nga pozitat që kishin në Shërbimin Policor të Kosovës, fakt ky që në atë kohë, sfidoi qëndrueshmërinë e një force policore shumë-etnike.⁷⁰ Një problem i ngjajshëm ndodhi kur u bë transferi i përgjegjësisë buxhetore nga OBZHE tek buxheti i konsoliduar i Kosovës, ku pagesat e stafit pësuan rënie nga EUR 800 në EUR 150 të cilat rezultuan në shkurtim të numrit të ekspertëve ndërkombëtarë të trajnimeve.⁷¹ Siç shihet qartë, OSBE-ja ka arritur të krijojë një seri të strukturave institucionale të cilat kanë për mandat të monitorojnë dhe promovojnë diverzitetin etnik dhe ë sjellin ekspertizat e jashtme brenda forcës së policisë, si dhe të krijojë struktura të jashtme të cilat kanë për qëllim të mbajnë policinë e përgjegjshme, duke e marrë parasysht gjithmonë që zhvillimet politike në teren shpeshherë shkaktojnë ngecje në proces, i cili është pse i ngadalshëm, cilësohet të jetë i qëndrueshëm.

Në vitin 2014, Z. Skender Hyseni, në atë kohë Ministër i Punëve të Brendshme, theksoi në prezantimin e tij të Shqyrtimit Vjetor të Inspektoratit të Policisë, që keqpërdorimi i pozitës dhe neglizhimi i të drejtave të njeriut në policinë e Kosovës është ende çështje e cila duhet të adresohet, dhe premtoi që do të punojë për shtrirjen e IPK në nivel lokal për të forcuar përgjegjësitë e policisë, transparencën dhe sjelljen demokratike.⁷²

⁶⁶ ODIHR Përmbledhja Vjetore, 2017. E publikuar nga Warsaw: OSCE/ODIHR 2018

⁶⁷ OSBE Misioni në Kosovë. Mars 2005. Edukimi dhe Zhvillimi I Policisë, Dokument, fq. 1-3

⁶⁸ ibid. fq. 3

⁶⁹ Sekretariati I OSBE-së, 'Misioni I OSBE-së dhe autoritetet e Kosovës inagurojnë inspektoratin e policisë', 28/06/2006. Mund të e gjeni tek: <https://www.osce.org/kosovo/47478>

⁷⁰ OSBE, 2008. Zbatimi I programeve që kanë të bëjnë me policinë: Mësimet e nxjerra në Evropën Juglindore. SPMU Seria e Publikimit, Volumi 7, fq. 47, 52

⁷¹ ibid. p. 32

⁷² Ministria e Punëve të Brendshme. Raporti Vjetor i Inspektoratit të Policisë 2014, fq. 5

Sipas po të njëjtit raport, për vitin 2014, nga 96 punëtorë të IPK të cilët u janë nënshtruar trajnimeve, tre (3) kanë qenë pjesë e tyre të cilët ishin fokusuar në fushë e të drejtave të njeriut, të cilët ishin organizuar nga IKAP-I. Ky fakt tregon një përmirësim nga Rishikimi Vjetor 2013, ku asnjë trajnim në fushë e të drejtave të njeriut nuk ishte ofruar.⁷³ Njëjtë, në vitin 2015 dhe 2016, edhe pse Inspektorati shihet të ketë përmirësuar bashkëpunimin me IAP dhe KMDLNJ, asnjë trajnim specifik nuk është përmendur në raportet vjetore respektive.⁷⁴ Kështu që, sipas informatave ekzistuese në trajnimet e ofruara në IPK, edhe pse organizata ka qenë e përkushtuar për ngritjen e çështjes së të drejtave të njeriut, dhe ka krijuar lidhje me organizatat ndërkombëtare dhe IAP, trajnimet e organizuara në praktikë janë të limitura, ku numri i tyre ishte shumë i vogël në krahasim me nevojën e cekur dhe qëllimet. Çka është e rëndësishme të theksohet, është që asnjë nga këto raporte nuk përmend të drejtat e "komuniteteve etnike", mirëpo shihet që është përdorur një term ombrellë më i gjërë siç është "të drejtat e njeriut".

Sa përket planit më të gjërë strategjik për trajnimin e nënpunësve civil, siç është paraqitur në udhërrëfyesin strategjik 2016 – 2022, MAP ka zhvendosur objektiven e përgjithëm, me qëllim për të u përputhur me aspiratat e ardhshme të Kosovës për të u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, ku si rrjedhojë, programet e trajnimit janë dhe do të jenë të fokusuar tek efikasiteti, profesionalizmi, kontrollimi, modernizimi dhe njohuritë e përgjithshme të shërbyesve civil rreth standardeve dhe procedurave të Bashkimit Evropian.⁷⁵ Si të tilla, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve nuk janë përfshirë si trajnim specifik. IKAP-i vazhdon të jetë institucioni përgjegjës për zbatimin e gati të gjitha trajnimeve për nënpunësit civil, si institucion fillestar përgjegjës apo si institucion sekondar/mbështetës.⁷⁶ Sido që të jetë, si reference e rezultateve të IKAP-it gjatë periudhës 2011 – 2013, Ministria ka theksuar që

"[...] Nuk ka një praktikë standard që rregullon bashkëpunimin në mes të IKAP-it dhe ministrive. Përderisa disa ministri kanë përmendur disa forma të bashkëpunimit, disa të tjerave nuk kanë përmendur bashkëpunimin. Zakonisht, trajnimet nuk janë të obligueshme dhe nuk kanë pasur ndonjë ndikim në performancën e nënpunësve civil. Pjesëmarrësit në trajnimet e IKAP-it, zakonisht kanë marrë vetëm certifikata të pjesëmarrjes. Në nivel komunal, nuk ka fare të dhëna të pjesëmarrjes në trajnimet gjatë viteve të kaluara."⁷⁷

Vlerësimi i trajnimeve të ofruara Akademisë së Policisë

Në mënyrë që të kuptojmë çështjet e shtjelluara nga programet ekzistuese të trajnimeve në fushë e të drejtave të njeriut, ECMI Kosova dhe ERAC kanë mbajtur një intervistë me Z. Kastriot Jashari, Drejtor i Departamentit të Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore, Akademia e Policisë.⁷⁸ Pyetësorët gjithashtu janë shpërndarë me trajnerët dhe të trajnuarit, me pyetje të cilat fokusohen në përmbajtje të trajnimit dhe në përvojën e pjesëmarrjes në trajnime për të drejtat e njeriut në Akademi të Policisë. Nga pesëmbëdhjetë (15) pyetësorë (5 për trajnerë dhe 10 për të trajnuarit), dhjetë (10) prej pyetësorëve i kemi marrë të plotësuar (5 nga trajnerët dhe 5 nga të trajnuarit). Pyetësorët kishin për qëllim të nxjerrin të dhëna qualitative, me qëllim të adresojnë përvojën e pjesëmarrësve në trajnimet e organizuara në fushën të drejtave të komuniteteve gjatë viteve.

⁷³ Ministria e Punëve të Brendshme. Raporti Vjetor i Inspektoratit të Policisë 2013, fq. 31

⁷⁴ Ministria e Punëve të Brendshme. Raporti Vjetor i Inspektoratit të Policisë 2015; Ministria e Punëve të Brendshme. Raporti Vjetor i Inspektoratit të Policisë 2016.

⁷⁵ Ministria e Administratës Publike. Strategjia për trajnimin e nënpunësve civil 2016-2020, fq. 5-6

⁷⁶ Ministria e Administratës Publike. Plani i Veprimit për periudhën tri vjeçare 2016-2018 për zbatimin e strategjisë për trajnimin e nënpunësve civil 2016-2020.

⁷⁷ Ministria e Administratës Publike. Strategjia për trajnimin e nënpunësve civil 2016-2020, fq. 13

⁷⁸ Intervista e zhvilluar të hënën 26 mars 2018, tek Akademia e Policisë, Vushtri.

Në lidhje me organizimin, Z. Jashari, sqaroi që Akademia e policisë, funksionin në kuadër të buxhetit të saj, të përcaktuar dhe të pavaruar, dhe programet educative janë të zhvilluara në bashkëpunim me partnerë jo-qeveritarë dhe organizatat ndërkombëtare (siç është OSBE-ja). Përmbajtja është pregatitur në bazë të nevojave specifike të secilit divizion zbatues i ligjit, qëllimet e kurrikulës janë vendosur në bashkëpunim me trupat e interesuar dhe aprovuar nga institucioni mbikqyrës dhe, në fund pas përfundimit të programit të trajnimit, pjesëmarrësit japin komente për programin, organizimin në tërësi dhe të tregojnë përvojën e tyre dhe të japin rekomandime. Sipas Z. Jashari, komentet e marra nga pjesëmarrësit deri tani kanë qenë positive, dhe janë fokusuar më shumë tek nevojat teknike/praktike, dhe nuk ka pasur ndonjë kërkesë për trajnime më të detajuara në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo gjithashtu është bërë e evidente nga përgjigjet në format e vlerësimit të plotësuar nga studentët, detyrë që është marrë nga divizioni adekuat i kualitetit që vlerëson metodologjinë, përmbajtjen e ligjëratës dhe çështjet praktike. Përgjatë trajnimeve, Akademia ka qenë në kontakt të afërt me studentat dhe, në punëtorinë vjetore të organizuar ku të gjitha palët e interesuara për kurrikulën e trajnimit ishin prezente, komentet dhe rekomandimet e studentëve janë marrë për bazë dhe do të shqyrtohen gjatë procesit të planifikimit të trajnimit të ri.

Në përgjithësi, duket të jetë një strukturë, duke përfshirë planifikimin e përmbajtjes së kurrikulës dhe punëtorinë vjetore e cila sjellë bashkë të gjithë akterët apo organet e interesuara të arsimit, vlerësimit të cilësisë dhe merr për bazë reagimet, komentet, rekomandimet e pranueshme nga studentët. Trajnimet janë të obligueshme dhe, edhe pse pjesëmarrësit nuk marrin ndonjë vlerësim apo nuk kanë ndonjë përfitim tjetër, marrin diploma të pjesëmarrjes. Gjithashtu, pjesëmarrja në një numër të trajnimeve të ofruara janë kusht për të diplomuar.

Në lidhje me trajniet specifike që mbulojnë fushën e të drejtave të njeriut apo mbrojtjen e komuniteteve etnike nga diskriminimi, megjithatë, Z. Jashari thotë që edhe pse qëllimet janë gjithmonë të ketë organizim të trajnimeve që trajtojnë çështjen në fjalë, mirëpo përmend që ka mangësi strukturorë që ky aktivitet të ndodhë. Edhe pse kurrikula dhe përmbajtja e trajnimeve është e përkthyer dhe është në dispozicion, dhe ekziston një divizion i veçantë brenda Akademisë i cili ka për qëllim të ofrojë mbështetje komuniteteve që flasin gjuhët tjera që janë zyrtare në Kosovë sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, rëndësia dhe kuptimi i trajnimeve në fushën e "të drejtave të njeriut" mbetet ende paqartë.

Për çështjen në fjalë, megjithëse pyetjet për të intervistuarit ishin formuluar në mënyrë që të nxjerrim sa më shumë të informata në lidhje me trajnimet që prekin fushën e të drejtave të njeriut dhe kundër diskriminimit, shumica e përgjigjeve të dhëna nga Drejtorët, ishin të drejtuar të përshkrimi i çështjes së programeve të trajnimit në përgjithësi të ofruara nga Akademia. Kështu që, u bë e qartë që edhe nëse fusha e të drejtave të njeriut gjindet në kurrikulë, është e përshkruar në mënyrë të përgjithshme, dhe Akademia nuk ka ndonjë rregull të veçantë apo plan afatgjatë i cili do të kontribuojë në luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si pjesë të Policisë. Një obzervim i tillë është bërë i dukshëm nga dy përgjigjet e Drejtorit të Trajnimit. Kur e kemi pyetur se nëse për Akademinë koncepti ombrellë i "të drejtave të njeriut" specifikisht ka për qëllim të prek diskriminimin kundër komuniteteve të etnive të ndryshme në nivel rajonal, Drejtori është përgjigjur që Akademia vepron në kuadër të principit të barazisë absolute. Si i tillë, drejtori shpjegoi që si me të trajnuarit dhe pjesëtarët e Akademisë, sikurse edhe në takimet e organizuara me qytetarë, Akademia nuk trajton çështjen e diskriminimit etnik si problem në vetvete pasi që me status dhe strukturë kjo shkelje hyn tek barazia etnike. Edhe pse vlen të theksohet përkushtimi i Akademisë në trajtimin e çështjes së diskriminimit, në këtë rast është shqetësuese mohimi nga niveli institucional, dhe kështu mbetet çështje e cila duhet trajtuar më shumë.

Kur është pyetur në Akademia e Policisë është në kontakt me Forcën e Policisë së Kosovës për të marrë informacion për ankesat formale dhe joformale të qytetarëve për Policinë në lidhje me diskriminimin e bërë, në mënyrë që të futet ky fenomen në programet e trajnimit, Z. Jashari sqaroi që këta dy trupa janë komplet të ndarë. Më marrjen e kësaj informate, ECMI Kosova beson që është e domosdoshme që Akademia të krijojë një mekanizëm të bashkëpunimit ndër-institucional me Forcën e Policisë së Kosovës, Departamentin e Drejtësisë dhe Institucionin e Ombudspersonit, me qëllim të marrjes së të dhënave statistikore mbi rastet e diskriminimit në mënyrë që të i përdorin ato informata për të i përmirësuar trajnimet e ardhshme për të drejtat e njeriut. Për më tepër, fakti që një e dhënë nuk është publike dhe e çasshme, dhe nuk ndahet në mes të FPK-së dhe Akademisë, shtron pyetjen se a janë këto trajnime që ofrohen të ndërlidhura me nevoja sociale apo janë duke i zbatuar vetëm për të përmbushur përpjektjen e Kosovës për të l përmbushur standardet e BE-së.

Në lidhje me trajnimin i cili po ofrohet kadetëve, Akademia e Policisë i ka ofruar çasje ECMI Kosovës tek kurset. Kursi "të drejtat e njeriut" është i dedikuar për studentë të cilët e kanë përfunduar trajnimin fillestarë, trajnim ky që zgjatë gjishtë (6) muaj. Kursi organizohet dhe zgjatë pesë (5) ditë, dhe zgjatë gjithsejt 35 orë klasa dhe testi. Çdo sesion zgjatë dy (2) orë, dhe pesë (5) orët e fundit të kursit janë të dedikuara për test, kontrollim të testit, shpërndarja e formave të vlerësimit tek studentët dhe shpërndarja e certifikatave studentëve që kanë korrur sukses.⁷⁹ Dy (2) sesionet e para janë të dedikuara për njohuri të përgjithshme të rolit të Policisë dhe pozicioni i këtij institucioni në shoqëri, duke u bazuar në legjislacionin relevant në fuqi dhe parimet demokratike. Kurrikula pastaj përmban sesionet hyrëse për të drejtat e njeriut, diskriminimin dhe Ligjet Ndërkombëtare (Mësimet #3-#6). Mësimet pasardhëse (#7-#14) përfshijnë konventat Ndërkombëtare për të drejtat e Njeriut, e drejta për jetë, ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit; e drejta për liri dhe siguri; liria e mendimit, fesë, shprehjes dhe lëvizjes. Mësimi # 10 fokusohet në sjelljen e Policisë në procedurën paragjyqësore dhe shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut.

Siç është e dukshme nga ky pasqyrim, edhe pse numri i sesioneve është i kënaqshëm, nga ana e përmbajtjes dhe shpërndarjes, çështjet praktike janë në mënyrë të dukshme të prezantuara në nivelin e kënaqshëm në krahasim me udhëzimet në Ligjin dhe Konventat Ndërkombëtare. Nga tridhjetë (30) orët e trajnimit, kadetëve u ofrohet dy (2) orë trajnim në fushën e diskriminimit dhe dy (2) orë tjera në sjelljen e policit, abuzimet potenciale dhe procedurat paragjyqësore. Përderisa teoria dhe harmonizimi me standardet ndërkombëtare janë padyshim të dobishme në trajnimin e kadetëve të rinjë, ku qëllimet me të vërtetë duket të jenë të mira, programi i dorëzuar po merret me praktikën e përditshme të policisë në mënyrë joefektive. Një qasje më shkurt e përmbledhur tek teoria dhe njohuria bazike e instrumenteve ndërkombëtare në kombinim me trajnimet të cilat fokusohen tek rastet specifike studimore që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe abuzimin e policisë dhe analizojnë në praktikë këto çështje, mund të ofrojnë njohuri më efektive për kadetët, pa pasur nevojë të rrisin numrin e sesioneve apo orëve të trajnimit.

Një pjesë e problemeve të lartëpërmendura janë bërë të dukshme në pyetësorë dhe gjithashtu pjesëmarrësit kanë ngritur zërin për shqetësimet e tyre dhe kanë propozuar një mori zgjidhjesh. Një tipar i cili bëhet i dukshëm nga përgjigjet e trajnerëve, është propozimi i tyre për më shumë bashkëpunime ndër-rajonale ku do të mund të ndahen praktikat më të mira.

⁷⁹ Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës. Përmbledhja e Kursit: Të drejtat e njeriut. fq. 2, 5

Edhe pse duken të jenë të kënaqur me përmbajtjen e programit që ofrojnë, ata në mënyrë të vazhdueshme theksojnë se si trajnimet mund të përmirësohen nëse do të kishte kontakte me kolegët nga Evropa, programge të shkëmbimit në mes të akademive që ofrojnë trajnime dhe bashkëpunim më i ngushtë me vendet tjera të Ballkanit në ndarjen e praktikave më të mira në çështjen në fjalë. Dy (2) trajnerë kanë përmendur nevojën për të përditësuar teknologjinë dhe një person ka theksuar si problem shumë të madhe mungesën e bashkëpunimit të brendshëm në përpilimin dhe planifikimin e programeve të trajnimit. Ky qëndrimi i fundit mbetet veçanërisht i rëndësishëm në lidhje me diskutimet brenda institucionit në lidhje krijimin e një moduli i cili fokusohet në të drejtat e komuniteteve etnike, i cili dukshëm mungon. Edhe pse dispozitat strukturore janë bërë me qëllim të konsiderojnë komentet e programeve të kaluara dhe të përdoren për të përmirësuar programet në të ardhmen, në praktikë, kanalet e komunikimit duken të jenë mjaft të bllokuara dhe ngadal adaptojnë dhe tejkalojnë sfidat e reja.

Ajo që mbetet interesante në vlerësimin pozitiv të të anketuarve në lidhje me përpjekjet e Qeverisë për trajnimin e nënpunësve të tyre në fushë e të drejtave të njeriut, është që, sipas kurrikulës ekzistuese dallime midis termit ombrellë të "të drejtave të njeriut" dhe një trajnimi ku trajtohen "të drejtat e komuniteteve" në mënyrë specifike. Siç shihet edhe nga kurrikula, trajnimi "të drejtat e njeriut" është fokusuar në aspektin ligjor të konceptit, fakt ky që bëri që një numër i të trajnuarve të sfidohen dhe të kenë problem gjatë trajnimit. Gjithashtu, edhe trajnerët edhe të trajnuarit nuk ishin në gjendje të bëjnë dallimin në mes të të drejtave të njerit në përgjithësi dhe të të drejtave të komuniteteve në veçanti, dhe shumë pyetje të cilat ishin fokusuar për kurset që trajtojnë të drejtat e komuniteteve kanë mbetur pa përgjigje apo përgjigjet janë të dhëna për konceptin e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Shembulli më mir i cili tregon mungesën e trajnimeve të ofruara në fushën e të drejtave të komuniteteve, është rasti i një përfaqësuesi i një institucioni të Kosovës, tek e cila është dërguar pyetësori për të u plotësuar. Në vend që të shkruajë datën e plotësimit të këtij pyetësori, personi kishte shkruajtur datën e trajnimit që ajo e ka ndjekur, që ishte data 21 shtator 2001. Kështu që, ne kemi kuptuar që ajo nuk ka qenë pjesë e ndonjë trajnimi tjetër pasues që nga ajo kohë, dhe parimet e saja bazohen tek legjislacioni në fuqi dhe Konventat Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një keqkuptim tillë, tregon se të paktën një person nga institucioni i Policisë së Kosovës ka qenë pjesë e një programi të trajnimit rreth pesëmbëdhjetë (15) vite më parë dhe nuk është bërë pjesë e ndonjë programi të ngjashëm. Kjo e gjetur është shqetësuese dhe sygjeron që, përveç që trajnimet për Policinë duhet të përditësohen, është e domosdoshme të ripërtrihet akreditimi i personave që janë të agazhuar në Polici dhe të cilët supozohet se kanë qenë pjesë e një programi të trajnimit në një kohë gjatë karrierës së tyre.

Në nivelin tjetër paralel, shumica e pjesëmarrësve kanë konfirmuar që vazhdimisht e përcjellin legjislacionin që prek të drejtat e njeriut, pa identifikuar ndonjë procedurë të veçantë që është bërë funksionale në institucionet e nivelit lokal për të mbrojtur që Policia merr pjesë në mënyrë aktive kundër diskriminimit. Nuk duken të jenë të themeluara procedura administrative apo të llogaridhënies, një fakt që kontribon të dobësojë sistemet e lart-përmendura të cilat sjellin rastet e diskriminimit para drejtësisë.

VI. PËRFUNDIMET

Mekanizmat për mbrotjen e komuniteteve dhe të drejtave të tyre, rregullohen dhe përcaktohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës. Të gjeturat e këtij raporti, tregojnë se në nivel qendror dhe lokal ekzistojnë disa mekanizma që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe mekanizma që mbrojnë dhe promovojnë në mënyrë specifike të drejtat e komuniteteve dhe janë: Zyra për Qeverisje të Mirë; Zyra për Çështje të Komuniteteve; Këshilli Konsultativ për Komunitete; Zyra e Komisionerit të Gjuhëve; Ministria për Komunitete dhe Kthim; Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim; Njësitë Ministrore për të Drejtat e Njeriut; Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim; Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut; Komitetet Komunale për Komunitete; dhe Institucioni I Avokatit të Popullit të Kosovës. Për më tepër, në sektorin e zbatimit të ligjit ekzistojnë disa institucione të tjera që gjithashtu shërbejnë në mënyrë direkte dhe indirekte si mekanizma mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe pecifik të të drejtave të komuniteteve siç janë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Këshilli Prokurorial i Kosovës; Policia e Kosovës; Akademia e Drejtësisë; dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Duke u bazuar në hulumtimin e bërë të raporteve dhe dokumenteve tjera të ndryshme të publikuara të cilat prekin këtë çështje, dhe pyetësorët dhe intervistat e bëra me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, informatat e marra tregojnë që ekziston një zbrastëritje në programet e trajnimit apo trajnime që dedikohen dhe mbulojnë fushën e të drejtave të komuniteteve. Sipas Ligjin për Qasje në Dokumenta Publike, institucionet publike kanë obligim ligjorë të u përgjigjen kërkesave të qytetarëve për të pasur qasje në dokumentat publike. Mirëpo, përgjigjet e marra nga dërgimi I pyetësorit të dërguar, nuk ishin të kënaqshme, ky vetëm 13 nga 38 Komuna dhe 6 nga 21 Ministri u janë përgjigjur.

Institucionet Qeverisë së Kosovës, ato në nivelin qendrorë dhe loka, nuk kanë programme të trajnimeve si të tilla. Mirëpo, organizohen trajnime me raste, të cilat për shembull Zyra për Qeverisje të Mirë, i organizon. Sipas përgjigjeve që I kemi marrë, kjo përgjegjësi I takon IKAP, I cili në konsultim me institucionet relevante, duhet të zhvillojë programme të trajnimeve duke u bazuar në nevoja dhe kërkesa. IKAP-I nuk ka ndonjë program të veçantë të trajnimit I cili mbulon fushën e të drejtave të komuniteteve specifikisht, por kjo fushë është e integruar në disa programme të trajnimit. Institucionet e Qeverisë së Kosovës, e kanë për obligim të ngrisin kapacitetet e nënpunësve civil, megjithatë, duke u bazuar në përgjigjet e marra nga pyetësorët dhe intervistat, trajnimet organizohen me kërkesë të vet nënpunësve civil. Pasi që nuk ka kërkesa për organizim të trajnimeve që mbulojnë fushën e të drejtave të komuniteteve, mund të themi që drejtpërdrejtë nuk ka mungesë të organizimit të tyre. Duke e marrë parasysh që rastet e shkeljeve të të drejtave të komuniteteve dhe raste e diskriminimit raportohen tek asistentët/asistenet ligjorë/ligjore të ERAC, shohim që ka nevojë të madhe për organizim të trajnimeve që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e komuniteteve në Kosovë.

Organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit kanë programet dhe kurset e tyre të trajnimit. Akademia e Drejtësisë ka kurse për të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve, duke përfshirë edhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të zbatueshme në Kosovën. Për më tepër, Akademia e Drejtësisë, e ka një kurs një (1) vjeçarë për gjyqtarët dhe prokurorët, ku në përfundim të tij, të gjithë pjesëmarrësit pajisen me certifikata. AKSP ka programe të plota të nivelit Bachelor, kurse dhe trajnime për policinë dhe nënpunësit civil nga sektori I sigurisë. As Akademia e Drejtësisë e as AKSP nuk kanë kurse specifike për të drejtat e komuniteteve, mirëpo kjo çështje është e integruar në modulet e përgjithshme në temën e të drejtave të njeirut.

VII. REKOMANDIMET

- Është e rëndësishme që regulloret institucionale dhe trajnimet në temën e të drejtave të njeriut të përfshijnë referenca specifike edhe për të drejtat e komuniteteve. Edhe pse të drejtat e komuniteteve janë të përfshira në KEDNJ, termi ombrelle shpesh pengon zbatimin e shumë rasteve, pasi që zyrtarët i u shmangen specifikave duke i përgjithësuar referencat duke u bazuar në ligj dhe jo në veprime specifike.
- Kosova duhet të mere pjesë në programet ndërkombëtarë të trajnimeve dhe seminareve. Siç shihet qartë në Raportin Vjetore 2017 të ZIDDNj, edhe pse të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimorë marrin pjesë në programe të trajnimeve për të drejtat e njeriut dhe krimet e urrejtjes, Kosova nuk ka qenë e përfshirë në shumicën e trajnimeve.⁸⁰ Mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtarë ishte gjithashtu një tipar që e kemi marrë nga përgjigjet e trajnerëve mbi programet e tanishme në forcën e policisë, dhe mund të këshillojmë të ketë programe të shkëmbimit me vendet tjera të Ballkanit dhe Evropës në mënyrë që të rritet shkëmbimi i praktikave më të mira në mes shteteve.
- Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të mirren hapa konkret në nivelin lokal për të mbështetur iniciativa që rrisin vetëdijen dhe trajnimet në fushë e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve etnike në të shtetin. Komunitat duhet të bashkëpunojnë me OJQ-të lokale dhe organizatat ndërkombëtare për zbatimin e programeve të trajnimeve për nënpunësit civil të cilat sigurojnë që instrumentet ndërkombëtare miratohen në nivel lokal.
- Në lidhje me trajnimet në nivel institucional, është shumë e rëndësishme që trajnimet për të drejtat e komuniteteve dhe të drejtat e njeriut të bëhen të obligueshme dhe të vazhdueshme. Siç shihet nga forcat e policisë, personeli i policisë ka qenë pjesë e vetëm një (1) trajnimi për të drejtat e njeriut, pa seanca pasuese ose seminare të përditësuara për të pasqyruar zhvillimet në legjislacion dhe praktikën e mira. Sygjerohet që përmbajtja e programeve të trajnimeve të tanishme të rishikohet në mënyrë që organizimi i tyre të ketë efekt më të madhë pozitiv, dhe të organizohen një seri e sesioneve pasuese/përcjellëse për nënpunësit civil të cilët kanë qenë pjesë e trajnimeve më herët se tre (3) vite (kur ligji i fundit kundër diskriminimit është miratuar).
- Komunikimi ndër-institucional duhet të jetë i sistematizuar. Fakti që rastet studimore të raportuara dhe ankesat e qytetarëve kundër trupave të ndryshëm nuk raportohen tek programet e trajnimit, bën që përmbajtja të jetë shumë teorike për të prezantuar dhe kuptuar problemin siç është në realitet, si një dukuri e përditshme. Veçanërisht brenda departamentit të policisë, rekomandohet shumë që ankesat e bëra kundër policisë të merren si shembuj e një praktike të keqe kundër komuniteteve gjatë seminareve/trajnimeve/punëtorive për të drejtat e njeriut/komuniteteve.
- Financimi i programeve të trajnimeve dhe monitorimin e tyre sygjerojmë të ngritet në mënyrë drastike. Siç shihet dukshëm në një numër të rasteve të studimit, edhe pse shumë iniciativa të mira prekin çështjen e diskriminimit ndaj komuniteteve, mungesa e fondeve e nënvlerëson punën e mirë të institucioneve siç është ZQM.

⁸⁰ ODIHR Annual Review, 2017. Published by the OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights, pp. 46, 58

- Është gjithashtu e këshillueshme që trajnimet për të drejtat e komuniteteve të jenë të lidhura direkt me një system të shpërblimeve, në mënyrë që të stimulojë nëpunësit civil të marrin pjesë në mënyrë active. Tani, edhe në gjyqësor edhe ne forcën e policisë, të trajnuarit marrin diploma të pjesëmarrjes, edhe pse ato nuk sjellin ndonjë përfitim apo progress në pozita.
- Në institucionet që janë në kontakt direkt me publikun, siç janë gjyqësori dhe forca e policisë, është e domosdoshme që multi etniciteti i këtyre institucioneve të monitorohet dhe të rritet.

VIII. REFERENCAT

Qendra për SEELS. 2016. Mbrojtja Ligjore kundër Diskriminimit në Evropën Juglindore: Studim Rajonal. <http://www.seelawschool.org/pdf/Book-Legal-Protection-Against-Discrimination-SEE.pdf>

Ministria e Administratës Publike, Kosovë. 2016. Plani I Veprimit I Strategjisë për Trajnimin e nënpunësve Civil 2016-2020. <https://map.rks-gov.net/getattachment/649247f0-f60a-4fd0-aae6-30ab39c933ac/.aspx>

Kushtetuta e Kosovës. 2008. Artikulli 22 dhe Artikulli 60. <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

Kuvendi I Kosovës, 13 mars 2008, Ligji 03/L-047, 'Mbrojtja dhe Promovimi I të drejtave të Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë'. http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf

Kuvendi I Kosovës, 28 maj 2015, Ligji 05/L-021, 'Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi'. <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-021%20a.pdf>

Komisioni Evropian. 2016. Dokument I Punës së Stafit të Komisionit: Raporti I Kosovës 2016. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

ECMI Kosova. 2013. Komunitetet në Kosovë: Udhërrëfyes për professional që punojnë me komunitete në Kosovë. <http://www.ecmikosovo.org/uploads/ECMIKosovoDec2013GuidebookforProfessionalsENG.pdf>

Avokati I Popullit. Raporti Vjetor 2015. https://www.oik-rks.org/repository/docs/English_Annual_Report_2015_351292.pdf

Avokati I Popullit. Raporti Vjetor 2016. <https://www.oik-rks.org/en/2017/03/31/annual-report-2016/>

Avokati I Popullit. Raporti Vjetor 2017. <https://www.oik-rks.org/en/2018/03/30/annual-report-2017/>

Instituti Kosovar për Administratë Publike në Kosovë. Raporti Vjetor 2015.

Instituti Kosovar për Administratë Publike në Kosovë. Raporti Vjetor 2016.

Intervistë nga ECMI Kosova dhe përfaqësues të Koalicionit "Të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)" e mbajtur në janar 2018, me Refiçe Sylqevci, Drejtoreshë në IKAP.

Kosovë. Regullorja Nr.16/2013 Organizimi I Strukturës së Zyre së Kryeministrit [05.04.2013], Artikulli 40 "Zyra për Qeverisje të Mirë". http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Rregullore_Nr_162013_per_strukturen_organizative_te_Zyres_se_Kryeministrit.pdf

Intervistë nga ECMI Kosova dhe përfaqësues të Koalicionit "Të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)" e mbajtur në prill 2018, me Habit Hajredini, Drejtor I ZQM.

Visoka, G., Beha, A. Trupat Konsultuese të komuniteteve në Kosovë: Kërkimi për Emancipim Efektiv ose Pjesëmarrje abstrakte? Gazeta mbi etnologjinë dhe çështjet e komuniteteve pakicë në Evropë, vëll. 10, Nr.1 (2011).

Misioni I OSBE-së në Kosovë. 2012. Masat e Zbatimit të legjislacionit për të drejtat e njeriut <https://www.osce.org/kosovo/94360?download=true>

Bulletini Informativ i ECMI Kosovës. 2013. Mungesa Adekuate e Alokimit të Buxhetit dëmton rëndë punën e KKK. <https://us6.campaign-archive.com/?u=0e3bc8a45806bf65531105c4b&id=dad1ff692e&e=26afd14725>

OSBE. Performanca dhe Ndikimi I KKK-se, 2015-2016

<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/362846?download=true>

Zyra e Presidentit – KKK, Komunikatë, 21 dhjetor 2017

<http://www.ccc-rks.net/index.php/en/news/item/549-press-release-december-21-2017>

Intervista e ECMI Kosovës dhe ERAC me Z. Gazmen Salijević e bërë më 19 prill 2018.

<http://www.ecmi.de/fileadmin/downloads/publications/JEMIE/2011/VisokaBeha.pdf>

N.N. [Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Çështje të Komuniteteve]. <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,134>

Buletinet dhe Gazetat në mes të vitit 2010 dhe 2013, mund të l gjeni tek: <http://www.zck-ks.net/?page=2,120>

Komisioneri për Gjuhët. <http://www.komisioneri-ks.org/?page=1,33> <http://www.komisioneri-ks.org/?page=1,61>

ECMI Kosova. <http://www.ecmikosovo.org/en/Municipal-Level-Institutions>

Misioni i OSBE-së në Kosovë. <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/305531?download=true>

Komuna e Prishtinës. http://prishtinaonline.com/uploads/komiteti_per_komun..pdf

Intervistë nga ECMI Kosova dhe përfaqësues të Koalicionit "Të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)" e mbajtur në korrik 2018, me Merita Syla, Drejtoreshë e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Institucioni I Avokatit të Popullit në Kosovë.

Këshilli Gjyqësor I Kosovës. <http://www.gjyqesori-rks.org/en/>

Këshilli Prokurorial I Kosovës. <http://www.kpk-rks.org/en/>

Intervistë nga ECMI Kosova dhe përfaqësues të Koalicionit "Të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)" e mbajtur në gusht 2018, me Ganimete Juniku, Zyrtare, Departamenti Ligjorë, KGJK.

Misioni I OSBE-së në Kosovë. Maj 2002. Instituti Gjyqësor I Kosovës, Raport. <https://www.osce.org/kosovo/24637?download=true>

Kuvendi I Kosovës. 23 shkurt 2006. Ligji Nr. 02/L-25, "Themelimi I Institutit Gjyqësor të Kosovës", Artikulli 1, Paragrafet 1.7, 1.8. https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L25_en.pdf

Dekreti i Presidentit të Kosovës, 03 shkurt 2017. Ligji nr. 05 / L-95. 'Për Akademinë'. Shpallur me dekretin Nr. DL.-008-2017

Akademia e Drejtësisë në Kosovë. Programi i Trajnimit 2017.

Akademia e Drejtësisë në Kosovë. Trajnimi i Trajnerëve Program.

Akademia e Drejtësisë. Trajnimi për Menaxhimin e Administratës, dhe Stafi Administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive.

Këshilli Prokurorial i Kosovës. Kodi i etikës profesionale për stafin mbështetës, neni 7 'Mosdiskriminimi'. <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Legislacioni/Kodet/THE%20CODE%20OF%20PROFESSIONAL%20ETHICS%20FOR%20SUPPORT%20STAFF.pdf>

Akademia e Drejtësisë. Programi i Trajnimit Fillestar për Prokurorët e sapo-emëruar, f. 26-27; Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. 2016. Doracak për Trajnimin Praktik të Programit Fillestar të Trajnimit (ITP).

Intervistë nga përfaqësuesit e ECMI dhe ERAC në qershor 2018, me Besim Morinën, Koordinatorin e Programit, Akademinë e Drejtësisë.

Misioni i OSBE-së në Kosovë. 2005. Arsimi dhe zhvillimi i policisë, Fletë informacioni. <https://www.osce.org/kosovo/37595?download=true>

Gazeta Zyrtare e Kosovës, Nr. 26, 25. 2011. Ligji Nr. 04 / L-053. 'Për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike'. Shpallur me dekretin Nr. DL.-045-2011. <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Kosovo%20Academy%20for%20public%20safety.pdf>

ODIHR, 2017. Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Varshavë: OSBE / ODIHR 2018. <https://www.osce.org/odhr/annual-report/2017>

Sekretariati i OSBE-së. 2006. 'Misioni i OSBE dhe autoritetet e Kosovës inaugurojnë inspektoratin policor'. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/47478>

OSBE, 2008. Zbatimi i programeve të lidhura me policinë: Mësimet e nxjerra në Evropën Juglindore. Publikimi i SPMU Seria Vol. 7, f. 47, 52 <https://www.osce.org/secretariat/35659?download=true>

Ministria e Punëve të Brendshme. 2013. Inspektorati Policor i Kosovës Raporti Vjetor 2013. <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Annual-report-2013.pdf>

Ministria e Punëve të Brendshme. 2014. Inspektorati Policor i Kosovës Raporti Vjetor 2014. http://www.kosovopolice.com/repository/docs/Raporti_i_PK-se_per_vitin_2014_-_versioni_anglisht.pdf

Ministria e Punëve të Brendshme. 2015. Inspektorati Policor i Kosovës Raporti Vjetor 2015. http://www.kosovopolice.com/repository/docs/Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB_Policis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2015_-_ANGLISHT.pdf

Ministria e Punëve të Brendshme. 2016. Inspektorati Policor i Kosovës Raporti Vjetor 2016. <http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-ANG-2016.pdf>

Ministria e Administratës Publike. 2016. Strategjia për trajnimin e nëpunësve civilë 2016-2020. http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/THE_STRATEGY_FOR_TRAINING_OF_CIVIL_SERVANTS_2016-2020.pdf

Intervistë nga përfaqësuesit e ECMI dhe ERAC në qershor 2018, me Kastriot Jashari, Drejtor për Trajnim dhe Mbështetje Arsimore, Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës. 2017. Përmbledhje e kursit: Të Drejtat e Njeriut.

IX. SHTOJCA 1

Pyetërosi i shpërndarë tek institucionet në nivelin qendrorë dhe local.

Mohimet

Pyetërosi i mëposhtëm do të përdoret për hulumtimin që do të zhvillohet në kuadër të projektit "Të drejtat te barabarta për të gjithë", një projekt katër (4) vjeçar i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë. Qëllimi i këtij hulumtimi është vetëm të analizojë programet e trajnimit të Kosovës për nënpunësit publikë që janë të lidhur me komunitetet pakicë. Gjetjet do të përdoren në një raport i cili do të prezantohet në një konferencë të organizuar gjatë këtij viti dhe do të ndahet në faqen e internetit të ERAC dhe në mediat sociale në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Pyetësor

Emri i institucionit: _____

Pozita e tij / saj në institucion: _____

Komuna: _____

Data: _____

KAPITULLI I: Programi i Trajnimit

- 1) A keni pasur apo keni ndonjë program trajnimi në lidhje me të drejtat e komuniteteve pakicë?
- Po, kishte
 - Jo, nuk kishte
 - Po, ka
 - Jo, nuk ka

- 2) Nëse do të kishte, a ishte programi i trajnimit i inkorporuar në një program më të madh apo është një program trajnimi i ndarë (Ju lutem shpjegoni).

- 3) Nëse ka, a është programi i trajnimit i inkorporuar në një program më të madh apo është një program trajnimi i ndarë (Ju lutemi shpjegoni).

4) Nëse programi i trajnimit është / është inkorporuar në programin më të madh, ju lutemi jepni disa informacione të përgjithshme mbi mënyrën e hartimit të programit, metodologjinë dhe çfarë komponentash mbulon dhe nën cilën pjesë janë të drejtat e komuniteteve pakicë të mbuluara.

5) Nëse programi i trajnimit në lidhje me komunitetet minoritare është një program trajnimi i ndarë, çfarë është metodologjia dhe cilat janë çështjet që mbulohen. (Ju lutem shpjegoni).

6) Cila zyre brenda institucionit tuaj ka filluar, zhvilluar dhe financuar programin e trajnimit? (Ju lutem shpjegoni).

7) A ka ndonjë organizatë tjetër kombëtare dhe ndërkombëtare të përfshirë në zhvillimin e programit të trajnimit dhe financimin e organizimit të trajnimeve? (Ju lutem shpjegoni).

8) Si u zhvillua programi i trajnimit? Çfarë materiali është përdorur për zhvillimin e programit dhe a është materiali i trajnimit i qasshëm?

9) Si e ka institucioni juaj organizimin e programit të trajnimit në lidhje me komunitetet pakicë: A janë organizuar si një sërë trajnimesh (sa ditë) ose vetëm një herë trajnime (sa orë)? A janë organizuar përsëritës çdo gjashtë (6) muaj ose në vit? (Ju lutem shpjegoni).

KAPITULLI II: Pjesëmarrësit e Programit të Trajnimit

1) Kush ishin pjesëmarrësit e programit të trajnimit?

Si e shpërndaui institucioni juaj informacion në lidhje me programin dhe si u organizua procesi i zgjedhjes së pjesëmarrësve për t'u trajnuar për të drejtat e komuniteteve pakicë? (Ju lutem shpjegoni).

2) A morën pjesë pjesëmarrësit ndonjë certifikatë pas pjesëmarrjes me sukses në programin e trajnimit në lidhje me komunitetet pakicë?

- a. Po
- b. Jo

3) A kishte ndonjë takim pasues për programin e trajnimit në lidhje me të drejtat e pakicave? Nëse po, ju lutemi shpjegoni procesin dhe kush ishte përgjegjës për organizimin e procesit.

4) Sa njerëz janë trajnuar për të drejtat e komuniteteve pakicë gjatë tre (3) viteve të fundit?

- a. 0 - 100
- b. 101 - 200
- c. 201 - 300
- d. 301 - 400
- e. Më shumë

KAPITULLI III: Trajnerët e Programit

1) Si u zgjodhën trajnerët për të ofruar trajnime në lidhje me komunitetet pakicë? (Ju lutem shpjegoni).

2) A ishin trajnuesit e zgjedhur përfaqësues të institucionit tuaj ose ekspertë të pavarur? (Ju lutem shpjegoni).

3) A u janë nënshtruar trajnerëve çdo program para-trajnimi posaçërisht për të ofruar trajnime në lidhje me të drejtat e komuniteteve pakicë? (Ju lutem shpjegoni).

4) Nëse po, si u zhvillua, u dha dhe u financua programi Trajnimi për trajnerët? (Ju lutem shpjegoni)

5) A ndihmuan trajnerët në zhvillimin e programit të trajnimit? Nëse po, ju lutemi shpjegoni rolin e tyre.

6) A kanë trajnuar / ekspertët e programit të drejtat e komuniteteve pakicë përfaqësues të institucionit tuaj në mënyrë që ata në të ardhmen të mund të ofrojnë trajnime në lidhje me të drejtat e komuniteteve pakicë? (Ju lutem shpjegoni)

- a. Po
- b. Jo

7) Nëse po, ju lutemi jepni një informacion më të detajuar mbi procesin, programin dhe afatin kohor të këtij aktiviteti.

8) Sa trajnues u përfshinë në programin e trajnimit për nënpunësit publik lidhur me të drejtat e komuniteteve pakicë (gjatë tre (3) viteve të fundit)?

KAPITULLI IV: Sfidat gjatë gjithë procesit

1) Identifikoni 2-3 sfida me të cilat përballen institucionet tuaja në zhvillimin e programit:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

2) Identifikoni 2-3 sfida me të cilat ballafaqohen institucionet tuaja në organizimin e sesionit të trajnimit:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

3) Identifikoni 2-3 sfida me të cilat përballen institucionet tuaja në përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

